



Për:	Znj. Vlorë Tosuni – U.D. Udhëheqëse në Njësinë për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike – Ministria e Ekonomisë
Nga:	z. Habil Zeqiri – U.D. Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KRU "Hidromorava"- SH.A. në Gjilan
Përmes:	Znj. Ajsun Abdullahu Sadiku – Sekretare e KRU "Hidromorava"- SH.A.
Lënda:	Raporti i punës për Tremujorin e tretë të vitit 2025 i KRU "Hidromorava"- SH.A. Gjilan
Datë:	26.11.2025

E nderuara znj. Tosuni,

Bordi i Drejtorëve me synim të përmbushjes së misionit dhe kryerjes së detyrave të tij në mënyrë sa më efikase dhe në pajtim me nenin 31.2. të Ligjit nr.04/L-111 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dërgon Raportin e punës për Tremujorin e tretë të vitit 2025 të Bordit të Drejtorëve dhe Ekzekutivit në KRU "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan, i miratuar unanimisht në Mbledhjen e njëmbëdhjetë të Bordit të Drejtorëve, e mbajtur me datë: 26.11.2025.


Me respekt.

**Raporti për tremujorin e tretë
të vitit 2025 i KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan**



Vendimi: 11/2025

Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan, unanimisht miratoi Raportin për tremujorin e tretë të vitit 2025 (TM3 – 2025) të KRU "Hidromorava" Sh.A., në mbledhjen e njëmbëdhjetë (XI-të) të Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datë: 26.11.2025.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv z. Ymer Salihu	U.D. Kryesues i Bordit të Drejtorëve z. Habil Zeqiri
Nënshkrimi:		
Data:	26.11.2025	26.11.2025



KRU
HIDROMORAVA

RAPORT I PUNËS

PËR TREMUJORIN
E TRETË TË VITIT

2025

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA / VLEDA / GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Nr. Proje. Proj. No. Org. Unit	0113
Nr. Prof. Prof. No.	4437
Datim: Date:	27.11.25
PRISHTINE A NO.1	

KRU
HIDROMORAVA



TABELA E PËRMBAJTJES

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV	7
1.1. Hyrje	7
1.2. Aktivitetet kryesore	8
1.3. Vendime dhe akte të tjera	10
2. BORDI I DREJTORËVE	14
2.1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve	14
3. KOMISIONI I AUDITIMIT	15
3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit	15
3.2. Përmbledhje e Raportit të Punës së ZAB për TM3/2025	15
4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV	17
4.1. Zyra e Burimeve Njerëzore	17
4.1.1. Struktura e të punësuarve	18
4.1.2. Procedurat e rekrutimit dhe përmbyllja e konkurseve	18
4.2. Zyra ligjore	18
4.3. Arkiva	20
5. DEPARTAMENTI FINANCIAR	22
5.1. Aktivitetet kryesore	22
5.2. Shqyrtimi i performances operative dhe financiare	22
5.2.1. Prodhimi i ujit në m ³	22
5.2.2. Faturimi i ujit në m ³	23
5.2.3. Faturimi i ujit në euro (€)	23
5.2.4. Arkëtimi i ujit/€	24
5.2.5. Përqindja e arkëtim	24
5.2.6. Shpenzimet operative	25
5.3. Pasqyrat Financiare – shtator 2025/2024	31
5.3.1. Shpalesje e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare deri më 30 shtator 2025	35
6. ZYRA E PROKURIMIT	41
7. DIVIZIONI PËR CILËSI TË UJIT	42
7.1. Cilësia e ujit	42

8. DEPARTAMENTI TEKNIK	45
8.1 Aktivitetet kryesore të drejtorit teknik	45
8.2 Divizioni për Prodhimin e Ujit dhe Stacionet e Pompimit	47
8.2.1 Furnizimi me ujë dhe defektet e paraqitura	47
8.2.2. Implementimi i projektit FLOWS	48
8.2.3. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit	49
8.3 Mirëmbajtja e Rrjetit të Ujësllësit	50
8.3.1. DMA - zonat	52
8.4. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	53
8.5 Divizioni për planifikim dhe menaxhim të projekteve	54
8.5.1. Aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025	54

TABELAT

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM3/2025	8
Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM3/2025	11
Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese gjatë periudhës së TM3/2025	18
Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve gjatë periudhës së TM3/2025	18
Tabela 5. Lëndët e pranuar nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës së TM3/2025	19
Tabela 6. Numri i dokumenteve të protokolluara sipas njësive gjatë periudhës së TM3/2025	21
Tabela 7. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m ³	22
Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m ³	23
Tabela 9. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)	23
Tabela 10. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit/€	24
Tabela 11. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit	24
Tabela 12. Paraqitja grafike e shpenzimeve në €	25
Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM3/2025 dhe TM3/2024 dhe plani TM3/2025	26
Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine Operative të Gjilanit TM3/2025 dhe krahasimi me TM3/2024	27
Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësine Operative të Kamenicës TM3/2025 dhe krahasimi me TM3/2024	28
Tabela 16. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine Operative në Vitise për TM3/2025, krahasimi me TM3/2024	29
Tabela 17. Treguesit - të hyrat dhe shpenzimet operative për TM3/2025 dhe krahasimi me TM3/2024	30
Tabela 18. Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë parane në banka dhe në arkë	35
Tabela 19. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera	35
Tabela 20. Stoqet	36
Tabela 21. Pasuritë tjera afatshkurta	36
Tabela 22. Pronat, impiantet dhe pajisjet	37
Tabela 23. Llogaritë e pagueshme	38
Tabela 24. Detyrimet tjera afatshkurtra	38
Tabela 25. Të hyrat e shtyra /grantet	38
Tabela 26. Ekuiteti	39
Tabela 27. Të hyrat	39
Tabela 28. Shpenzimet e shpërndarjes	39
Tabela 29. Shpenzime administrative të tjera	39
Tabela 30. Fitimi (humbja) para tatimit	40
Tabela 31. Ndryshimet në ekuitet	40
Tabela 32. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM3/2025 - vlerë minimale	41
Tabela 33. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM3/2025 - "procedurë e hapur - kuotim i çmimit"	41
Tabela 34. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM3/2025 - procedurë e hapur - vlerë e mesme	41
Tabela 35. Takimet e Drejtorit Teknik me institucionet relevante dhe operator ekonomik, gjatë TM3/2025	46

Tabela 36. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM3/2025	49
Tabela 37. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM3/2025	50
Tabela 38. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM3/2025 në DMA zonat për regjionin e Gjiçanit	52
Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, në rrjetin e kanalizimit kanë qenë gjithsej: 437 intervenime duke përfshirë Njësitë Operative në Gjiçan, Kamenicë dhe Viti. ..	
Tabela 39. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM3/2025	53
Gjatë kësaj periudhe gjithashtu, në Nj.O. në Gjiçan, kemi pasur (10) intervenime me autocisternë si dhe (13) vendosje të kapakëve në puseta të kanalizimeve.	
Tabela 40. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM3/2025 në Gjiçan	
Tabela 41. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM3/2025	54

SHËNIMET SHPJEGUESE

Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	35
Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera	35
Shënimet shpjeguese 3. Stoqet	36
Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta	36
Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata - pronat, impiantet dhe pajisjet	37
Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet	37
Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM3/2025	38
Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet tjera afatshkurtra	38
Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyera/grantet	38
Shënimet shpjeguese 10. Ndryshimi në ekuitet	39
Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat	39
Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes	39
Shënimet shpjeguese 13. Shpenzimet administrative të tjera	39
Shënimet shpjeguese 14. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit	40

FJALORI I AKRONIMEVE/SHKURTESAVE

ARRU	Autoriteti Rregullator i Ujërave
B.I.	Biznes Individual
DMA Zona	District Metered Area (Zona e Matjes së Rrjetit/Ujës-jellës)
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development (shqip: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim)

FLWS	Fostering and Leveraging Opportunities for Water Security (shqip: Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë Ujore)
FPU	Fabrika e Përpunimit të Ujit
GIS	Geographic Information System (Sistemi Gjeografik i Informacionit)
HM	Hidromorava
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IMF	Institucionet mikrofinanciare
ITUN	Impianti i trajtimit të ujërave të ndotur
KESCO	Kompania për shpërndarjen e Energjisë Elektrike të Kosovës
KIWER	Kosovar Institute for Water and Environmental Research (Instituti Kosovar për Kërkime në Fushën e Ujit dhe Mjedisit)
KRU	Kompania Rajonale e Ujësllësit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NTSh	Ndërmarrje Tregtare Shoqërore
Nj.O.	Njësi Operative e KRU Hidromorava Sh.A.
Sh.A.	Shoqëri Aksionare
ShPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
SHUKOS	Shoqata e Ujësllësave dhe Kanalizimeve të Kosovës
SHUKALB	Shoqata e Ujësllësave dhe Kanalizimeve të Shqipërisë
TVSH	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UPF	Uji i pafaturuar

FJALORI I TERMAVE TEKNIK TË PËRDORUR

Gypat AC	Gypat prej azbest/cementi
Gypat HDPE	Gypat prej polietileni të fortë dhe të qëndrueshëm
Gypat DN 80 mm	Gypat me diametër nominal 80 milimetra
Gypat PE	Gypat prej polietileni

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV

1.1. Hyrje

Ky raport i referohet periudhës raportuese të tremujorit të tretë të vitit 2025 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative të Ndërmarrjes, si dhe me përshkrimin e arritjeve të caqeve të Planit të Biznesit të KRU "Hidromorava" – Sh.A. Gjilan.

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025 Ndërmarrja ka vazhduar të përballet me një sërë sfidash të natyrës teknike, operative dhe financiare, të cilat kanë ndikuar në menaxhimin efikas të resurseve dhe në realizimin e objektivave strategjike të përcaktuara.

➤ Menaxhimi i prodhimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm

Një ndër sfidat më të theksuara gjatë periudhës së tremujorit të tretë ka qenë menaxhimi i prodhimit dhe furnizimi me ujë. Gjatë muajve të verës, siguri i furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm për të gjithë konsumatorët mbetet një ndër prioritetet kryesore të Ndërmarrjes.

Në këtë periudhë, furnizimi është menaxhuar me efikasitet të lartë, ku vetëm disa lagje të vogla, të vendosura në zona më të larta, kanë pasur herë pas here vështirësi në furnizim. Përveç këtyre rasteve të izoluara, pjesa tjetër e qytetit – pavarësisht temperaturave të larta dhe rritjes së konsumit – është furnizuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të rregullt.

➤ Inkasimi i borxheve të vjetra

Një sfidë e vazhdueshme gjatë TM3/2025 ka qenë arkëtimi i borxheve të vjetra, veçanërisht nga konsumatorët që nuk kanë kryer pagesat për një periudhë të gjatë kohe.

Vështirësitë në inkasim ndikojnë drejtpërdrejt në likuiditetin financiar të Ndërmarrjes, duke kufizuar mundësitë për investime në mirëmbajtje dhe zhvillim të infrastrukturës.

Një tjetër faktor pengues është baza ligjore aktuale, e cila mundëson parashkrimin e borxheve më të vjetra se një vit, duke e bërë procesin e arkëtitimit edhe më të vështirë.

➤ Dalja në treg të lirë për furnizim me energji elektrike

Një sfidë e konsiderueshme për Ndërmarrjen gjatë këtij tremujori ka qenë dalja në treg të lirë për furnizim me energji elektrike, e cila ka hyrë në fuqi më 1 qershor 2025.

Kjo ka rezultuar me rritje të ndjeshme të faturave të energjisë për muajt qershor, korrik dhe gusht – mbi 100% krahasuar me periudhat e mëparshme.

Këto shpenzime nuk janë të parapara në Planin e Biznesit 2025, as në procesin tarifor për vitin 2025, pasi që as ARRU nuk kishte pasur informata paraprake për këtë ndryshim që ndodhi në mes të vitit.

Në kuadër të kësaj çështjeje, Ndërmarrja ka zhvilluar takime me ARRU, ku të njëjtit kanë kërkuar nga ZRRE që për ujësjellësit të ketë përjashtim nga dalja në treg të lirë. Megjithatë, përgjigjja e ZRRE ka qenë negative, duke sqaruar se sipas ligjit, edhe Ndërmarrjet Publike duhet t'i nënshtrohen këtij procesi.

Për më tepër, është dërguar kërkesë zyrtare në ARRU për të mundësuar një proces të jashtëzakonshëm për ngritje të tarifës së ujit, por kërkesa është refuzuar, me arsyetimin se një proces i tillë është i pamundur për shkak të kohës së shkurtër dhe për faktin që ARRU tashmë është duke punuar në procesin e rregullt tarifor trevjeçar 2026–2028.

Sipas letrës zyrtare të ARRU, kostot shtesë për energji që do të shpenzohen gjatë shtatë muajve të fundit të vitit 2025 do të përllogariten në procesin tarifor 2026–2028.

➤ Menaxhimi i projekteve zhvillimore

Një tjetër sfidë që kërkon koordinim të lartë ndërsektorial është menaxhimi paralel i projekteve të shumta zhvillimore, përfshirë:

- Projektet e financuara nga të hyrat vetanake të Ndërmarrjes,
- Projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë,
- Projektin FLOWS me Bankën Botërore, dhe
- Projektin ITUZ me EBRD.

Projekti FLOWS është aktualisht në fazën e zbatimit në terren, ndërsa projekti EBRD – ITUZ ka hyrë në fazën përfundimtare të vlerësimit të ofertave.

➤ Përfundime dhe masa të ndërmarra

Pavarësisht sfidave të përmendura, KRU "Hidromorava" – Sh.A. mbetet e përkushtuar në zbatimin e masave konkrete për:

- përmirësimin e funksionimit operativ,
- menaxhimin efikas të resurseve, dhe
- garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë për të gjithë konsumatorët.

Ndërmarrja ka vepruar sipas Planit të Veprimit dhe ka ndërmarre hapa konkretë për adresimin e sfidave, duke përfshirë angazhimin aktiv me institucionet relevante për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe afatgjata.

1.2. Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, krahas angazhimeve të përditshme në menaxhim të Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv ka mbajtur edhe takimet e listuara në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM3/2025

Nr.	Institucioni	Data	Qëllimi i takimit
1.	Ministria e Ekonomisë	08.07.2025	Programi i punësimit të praktikantëve përmes programit Kosovà Generation Unlimited (K-GenU), i cili parasheh që Ndërmarrjet Publike të punësojnë praktikantë me pagesë, ku parashihet që pagesa të bëhet nga K-GenU, Ministria e Ekonomisë dhe Ndërmarrjet Publike.
2.	ARRU	10.07.2025	Takim me përfaqësuesit e ARRU-së, për të na njoftuar rreth metodologjisë së re të kalkulimit të tarifave, për procesin e ardhshëm tarifor tre vjeçar.
3.	ARRU	16.07.2025	Takim me përfaqësuesit e ARRU-së, për të diskutuar rreth shpenzimeve të energjisë elektrike, pas kalimit në treg të lirë, me ç'rast edhe kemi kërkuar shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifës, për shkak të dyfishimit të kostonë së energjisë elektrike.

4.	SHUKOS	23.07.2025	Është mbajtur Kuvendi i Jashtëzakonshëm i SHUKOS, ku njëra ndër pikat kryesore ka qenë pranimi i NP "Ibër Lepenci" në cilësinë e anëtarit të rregullt të SHUKOS me të drejtë vote.
5.	ARRU	24.07.2025	Vizitë nga ekipi i ARRU-së, për të diskutuar në lidhje me punën dhe vështirësitë që kemi hasur, gjatë plotësimit të dhënave me metodologjinë e re të procesit tarifar, ku edhe kemi marrë udhëzime se si duhet të vazhdojmë tutje në përgatitjen dhe futjen e të dhënave.
6.	SHUKOS	29.07.2025	Takim i Grupit Punues, me qëllim të hartimit të një "Plani të Veprimit" apo "Strategjie Kombëtare për Menaxhim të Llumit".
7.	ARRU	21.08.2025	Vizite e Drejtorit dhe zv. Drejtorit të ARRU në KRU "Hidromorava", ku qëllimi i takimit ka qenë që të diskutohen përgatitjet e Ndërmarrjes tonë për procesin e ardhshëm tarifar 2026-2028, efektet nga dalja në treg të lire të energjisë, rishikimi i çmimorës së ARRU, ngritja e gjobës për kycjet ilegale etj.
8.	SHUKOS	25.08.2025	Takim në SHUKOS, ku përveç pikave të rregullta është diskutuar edhe për organizimin e Konferencës dhe Ekspozitës së 13 Ballkanike, që do të mbahet nga data 11-13 nëntor 2025, e cila këtë vit sipas radhës do të mbahet në Shqipëri, në Grand Hotel Blue Fafa Resort në Durrës. Tema kryesore e Konferencës do të jetë: <i>"Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit përball ndryshimeve klimatike"</i> .
9.	GOPA	26.08.2025	Takim me përfaqësuesit e konsulentit të jashtëm GOPA, ku qëllimi i takimit ka qenë që pas nënshkrimit të dy marrëveshjeve, ajo për Ndërtim të Kolektorëve, si dhe ajo për Mbikëqyrje, të përshpejtohet procesi edhe për fazën e dytë të vlerësimit për Ndërtim të ITUN, pasi që për fazën e parë EBRD ka dhënë "No Objection".
10.	EBRD	27.08.2025	Në këtë takim të organizuar nga EBRD, të ftuar kanë qenë përfaqësuesit e lartë të EBRD, përfaqësuesit e lartë të kompanisë konsulente GOPA, si dhe përfaqësuesit e lartë të KRU "Hidromorava". Qëllimi i takimit ka qenë bashkërendimi i të gjitha palëve për përgatitjen e raportit final të fazës së parë të vlerësimit për Ndërtim të ITUN, të njoftohen kompanitë që janë kualifikuar në fazën e dytë, si dhe ato që nuk janë kualifikuar ti jepet 7 dite kohë për ankesa dhe pastaj të fillohet me fazën e dytë të vlerësimit për Ndërtim të ITUN.
11.	ARRU	01.09.2025	Takim me Menaxhmentin e ARRU, ku në këtë takim përveç tjerash është diskutuar edhe për ndikimin e shpenzimeve të energjisë pas daljes në treg të lirë dhe jemi dakorduar që përmes ARRU të drejtohet kërkesë te ZRRE që të bëhet përjashtim dhe KRU-të të mos dalin në treg të lirë të energjisë.
12.	EBRD	02.09.2025	Është zhvilluar takim me përfaqësuesit e (EBRD), ku ndër të tjera është diskutuar për përfundimin e fazës së parë të procesit të vlerësimit për ndërtimin e (ITUN). Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave, u theksua se duhet të fillohet menjëherë me fazën e dytë dhe përfundimtare të procesit të vlerësimit, me qëllim të përshpejtimit të dinamikës së zbatimit të projektit.

13.	Komuna Kamenicë	04.09.2025	Është mbajtur takim me Kryetarin e Komunës së Kamenicës, ku është diskutuar për projektet që po zhvillohen me bashkëfinancim, si dhe për projektet që KRU "Hidromorava" Sh.A. po i implementon në bazë të procesit tarifor. Gjatë takimit është bërë shqyrtimi i fazës aktuale të zbatimit të këtyre projekteve, si dhe janë trajtuar çështje të tjera me interes të ndërsjellë, me synim të thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përshpejtim të realizimit të projekteve në territorin e Komunës së Kamenicës.
14.	EBRD	04.09.2025	Në takimin e organizuar nga (EBRD), kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Kompanisë së Konsulencës, të cilët kanë prezantuar raportin final të fazës së parë të vlerësimit për ndërtimin e Impiantit të Trajtit të Ujërave të Ndotura (ITUN). Raporti është pranuar nga EBRD, dhe është marrë vendim që të vazhdohet me njoftimin e të gjithë (OE). Operatorët që kanë vërejtje ose janë të pakënaqur me rezultatet e vlerësimit, do të kenë mundësinë t'i dorëzojnë komentet e tyre brenda afatit prej 7 ditësh nga data e njoftimit.
15.	ARRU	15.09.2025	Në këtë takim kanë marrë pjesë Menaxhmenti i (ARRU) si dhe Kryeshefat Ekzekutivë nga të gjitha (KRU-të). Tema kryesore e diskutimit ka qenë njoftimi nga Menaxhmenti i ARRU lidhur me rrjedhën e takimit të mbajtur me (ZRRE). Sipas sqarimeve të dhëna nga përfaqësuesit e ZRRE-së, është e pamundur që KRU-të të përjashtohen nga obligimi për dalje në tregun e lirë të energjisë, për shkak të kufizimeve ligjore aktuale që janë në fuqi.
16.	Banka Botërore	22.09.2025	Është mbajtur takim me përfaqësuesit e projektit FLOWS, ku është diskutuar për përgatitjet për fillimin e punimeve të PAKO-s 2, që përfshin zgjerimin e Fabrikës së Ujit në Letnicë, ndërrimin e gypit kryesor në Kamenicë dhe ndërrimin e gypit në SP "BAJA" në Gjilan.
17.	SHUKOS	23.09.2025	Është mbajtur takimi i rregullt i Bordit të SHUKOS, ku janë diskutuar çështjet lidhur me organizimin dhe mbarëvajtjen e Konferencës së Përbashkët Ballkanike SHUKALB-SHUKOS, e cila këtë vit do të mbahet në Shqipëri, nga data 11-13 nëntor 2025. Gjithashtu, është marrë vendim (ARRU) t'i dërgohen propozime për ndryshime të çmimeve në kuadër të procesit tarifor 2026-2028.

1.3. Vendime dhe akte të tjera

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tij, Kryeshefi Ekzekutiv gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, ka nxjerrë 15 vendime të listuara si më poshtë:

Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM3/2025

Nr.	Vendimi	Numri i Vendimit	Data e protokollimit
1.	Vendim për caktimin e komisionit vlerësues të kandidatëve në kuadër të procedurës së rekrutimit për pozitën "Drejtor Teknik" në KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, sipas konkursit publik nr. 739, datë 05.06.2025.	813	03.07.2025
2.	Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, konform nenit 67, pika 1.4 dhe nenit 72 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr. 03/L-212, punëtorit Shaqir Ramadani, i sistemuar në vendin e punës Arkatar ndihmës – porto arkë pranë KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, i ndërpritet marrëdhënia e punës me datë 20.07.2025, për shkak se ka mbushur moshën ligjore të pensionit prej 65 vjet.	855	18.07.2025
3.	Vendim për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje verbale", me rekomandim të Komisionit Disiplinor të KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, punëtorit R.Sh, i shqiptohet masa disiplinore "Vërejtje Verbale".	869	23.07.2025
4.	Vendim për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim", me rekomandim të Komisionit Disiplinor të KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, punëtorit O.S., i shqiptohet masa disiplinore "Vërejtje me shkrim".	870	23.07.2025
5.	Vendim për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim", me rekomandim të Komisionit Disiplinor të KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, punëtorit N. L., i shqiptohet masa disiplinore "Vërejtje me shkrim".	871	23.07.2025
6.	Vendim për vazhdimin e përkohshëm të angazhimit të të punësuarit B.K. në detyrat e pozicionit: Ushtrues Detyre – Përgjegjës i Autoparkut, për periudhën 01.08.2025 deri më 31.12.2025.	926	01.08.2025
7.	Vendim për formimi i Komisionit të Ankesave për konkurset publike nr. 833, 834 dhe 835 të datës 11.07.2025, për shqyrtimin e ankesave për pozitat: Lexues i Ujëmatësve dhe Shpërndarës i Faturave, Teknik i Shkycjes dhe Kontrollit, dhe Punëtor i Pakualifikuar – Punëtor Fizik në Ujësjellës.	927	01.08.2025
8.	Vendim që të punësuarës R.A., e caktuar në detyrën Zyrtare për Konsumator pranë KRU "Hidromorava" Sh.A., i lejohet pushimi pa pagesë për një (1) muaj, për periudhën 05.08.2025 – 04.09.2025, për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore, në përputhje me nenin 40, paragrafi 1 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.	1096	05.08.2025

9.	Vendim për plotësim/ndryshimin e Vendimit nr. 927, datë 01.08.2025, për përbërjen e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve në konkurset publike nr. 833, 834 dhe 835, për pozitat: Lexues i Ujëmatësve dhe Shpërndarës i Faturave, Teknik i Shkyqjes dhe Kontrollit, dhe Punëtor i Pakualifikuar – Punëtor Fizik në rrjetin e ujësjellësit	1101	06.08.2025
10.	Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për konkursin publik nr. 835, datë 11.07.2025, për procedurën e rekrutimit për pozicionin: Punëtor Fizik i Pakualifikuar në rrjetin e ujësjellësit në KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjiilan.	1103	06.08.2025
11.	Vendim për formimin e komisionit vlerësues sipas konkursit publik, nr.833 të dt.11.07.2025, në procedurën e rekrutimit për pozitën punuese: "Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave në KRU "Hidromorava" - SH.A, në Gjiilan.	1104	06.08.2025
12.	Vendim për formimin e komisionit vlerësues sipas konkursit publik, nr.834 të dt.11.07.2025, në procedurën e rekrutimit për pozitën punuese: Teknik i shkyqjes dhe kontrollit në KRU "Hidromorava" - SH.A, në Gjiilan.	1105	06.08.2025
13.	Vendim nr. 1178, datë 22.08.2025: Punëtorit N.L., i sistemuar në detyrën Menaxher i Divizionit për Prodhim dhe Impiante të Ujit në KRU "Hidromorava" Sh.A., i është shqiptuar masa disiplinore - dënim me të holla në shumën 240.00 €, të zbritur nga paga e punonjësit.	1171	22.08.2025
14.	Vendim që punëtorit Pajazit Bajrami, Operator në FPU Përlepnice pranë KRU "Hidromorava" Sh.A., i lejohet pushimi pa pagesë për një (1) muaj, nga 02.09.2025 deri më 01.10.2025, për shkaqe shëndetësore, sipas nenit 40, paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.	1178	22.08.2025
15.	Vendim për emërimin e z. Valon Ismajli si Zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike në KRU "Hidromorava" Sh.A.	1182	26.08.2025
16.	Vendim për formimin e Komisionit të Ankesave, si organ i shkallës së dytë, për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve për shqiptimin e masës disiplinore ndaj të punësuarve, konform dispozitave të Rregullores mbi përgjegjësinë materiale dhe disiplinore të të punësuarve në KRU "Hidromorava" Sh.A., nr. 755, datë 28.06.2025.	1185	26.08.2025
17.	Vendim për lejimin e vazhdim të pushimit pa pagesë për të punësuarën R.K. edhe për një muaj, nga data: 05.09.2025 deri më 03.10.2025.	1240	05.09.2025

	Vendim për riaktivizimin e komisionit lidhur me problemet që paraqiten tek disa kategori të konsumatorëve për trajtimin e rasteve përkitazi me konsumatorët që nuk gjenden, faturat e dyfishta, etj.	1253	09.09.2025
18.	Vendim për lejimin e pushimit pa pagesë për të punësuarën N.K. edhe për një muaj, nga data: 16.09.2025 deri më 15.10.2025.	1286	15.09.2025
19.	Vendim për caktimin e komisionit për përpilimin e Planit të Menaxhimit të Ujëmatësve në KRU "Hidromorava" Sh.A.	1320	24.09.2025
20.	Vendim për dhënien e ndihmës/mbështetjes materiale në shumë prej: 150.00€ të punësuarit A.R., me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes - prindit.	1321	24.09.2025

2. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta.

2.1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve gjithmonë është bërë në mënyrë të lirë dhe demokratike duke e respektuar të drejtën e votimit të lirë, pa presion dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e shtatë të mbajtur me datë: 29.07.2025 ka marrë këto vendime:
 1. Unanimisht është miratuar "Raporti i Punës për muajin qershor të vitit 2025";
 2. Unanimisht është miratuar "Rishikimi i Planit të Biznesit për periudhën 2024-2026";
 3. Unanimisht është miratuar shpallja e Konkursit Publik për rekrutimin e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit nga data: 01.08.2025, me mandat tre vjeçar me mundësi vazhdimi;
 4. Unanimisht është miratuar vendimi për vazhdimin e mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv z. Ymer Salihu edhe për një periudhë tre (3) vjeçare e cila hyn në fuqi nga data: 01.08.2025 dhe përfundon me: 01.08.2028, me mundësi vazhdimi bazuar në vlerësimin e performancës së përgjithshme nga ana e Bordit të Drejtorëve.

- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e tetë të mbajtur 27.08.2025 ka marrë këto vendime:
 1. Unanimisht është miratuar "Raporti i Punës për muajin korrik të vitit 2025";
 2. Unanimisht është miratuar "Raporti i punës për tremujorin e dytë të vitit 2025".

- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e nëntë të mbajtur me datë: 19.09.2025 ka marrë këto vendime:
 1. Unanimisht është miratuar "Raporti i Punës për muajin gusht të vitit 2025".

3. KOMISIONI I AUDITIMIT

Komisioni i Auditimit gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, ka mbajtur një (1) mbledhje të rregullt dhe bazuar në procesverbalin e datës: 25.07.2025 ka shqyrtuar çështje në vijim:

3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava" Sh.A., në mbledhjen e katërt të mbajtur më 25.07.2025, ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin e Zyrarit të Auditimit të Brendshëm dhe çështjet në vijim:

- Unanimisht është miratuar "Raporti i Auditimit "Auditimi i mallërave, shpenzimeve dhe komunalive në KRU Hidromorava nr. 02/2025", me plotësim ndryshimet e kërkuara gjatë mbledhjes";
- Është shqyrtuar "Rishikimi i Planit të Biznesit për periudhën 2025 - 2027";

Komisioni i Auditimit, në tremujorin e tretë të vitit 2025, përmes postës elektronike ka shqyrtuar dhe marrë këto vendime:

- Me datë: 15.07.2025 Unanimisht është miratuar "Raporti gjashtëmujor i Auditimit të Brendshëm për periudhën 01.01.2025 - 30.06.2025 për KRU Hidromorava - Gjilan".

3.2. Përmbledhje e Raportit të Punës së ZAB për TM3/2025

Raporti i dorëzuar nga Zyra e Auditimit të Brendshëm (ZAB) për TM3/2025 pasqyron rezultatet e arritura krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara për këtë periudhë, dhe përfaqëson një raportim tërësor e gjithëpërfshirës mbi punën e realizuar.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025, ZAB ka realizuar aktivitete të rëndësishme të auditimit sipas Planit Vjetor të Auditimit, duke përfshirë kryerjen e tre auditimeve të planifikuara, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe fillimin e auditimit të ri në fushën e të hyrave.

Auditimet e realizuara gjatë TM3/2025

Gjatë periudhës janë zhvilluar këto auditime:

1. Auditimi 02/2025 - Shpenzimet për Mallra, Shërbime dhe Komunal

Auditim i fokusuar në vlerësimin e proceseve të shpenzimeve funksionale dhe respektimit të procedurave financiare.

2. Plani i Implementimit të Rekomandimeve - Raporti 2-1/2025

Vlerësim i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet paraprahe dhe i progresit të menaxhmentit në përmirësimin e kontroleve të brendshme.

3. Auditimi i projektit kapital:

"Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit dhe kalimi i kyçjeve individuale të konsumatorëve nga gypat AC në HDPE në qytetin e Vitisë" - Situacioni i dytë dhe përfundimtar.

Auditim mbi dokumentacionin teknik, financiar dhe përputhshmërinë e procedurave të ekzekutimit të projektit.

Aktivitetet në proces

- Ka filluar auditimi i të hyrave nga uji, kanalizimi dhe shërbimet e tjera, i cili do të vazhdojë në TM4/2025.

3. Aktivitetet këshilluese dhe parandaluese

ZAB, sipas kërkesave të menaxhmentit dhe në përputhje me Standardet e Auditimit të Brendshëm, ka ofruar edhe shërbime këshilluese dhe ndërhyrje parandaluese, me qëllim forcimin e kontrolleve të brendshme dhe rritjen e efikasitetit operacional.

4. ZYRA E SEKRETARES/DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, Zyra e Sekretares së Ndërmarrjes ka realizuar me përkushtim detyrat funksionale dhe ligjore, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për Bordin e Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe menaxhmentin e lartë të Ndërmarrjes. Aktivitetet kryesore janë fokusuar në administrimin dhe arkivimin e dokumenteve zyrtare, përgatitjen e materialeve për mbledhjet e organeve udhëheqëse, hartimin e raporteve periodike të punës dhe përgatitjen e akteve administrative në përputhje me kornizën ligjore dhe rregulloret e brendshme të Ndërmarrjes.

Në kuadër të përgjegjësiave institucionale janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

Përgatitja e procesverbaleve të mbledhjeve:

Janë përgatitur procesverbalet për mbledhjet e rregullta të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, përkatësisht:

- Procesverbali i mbledhjes së gjashtë të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 27.06.2025;
- Procesverbali i mbledhjes së shtatë të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 29.07.2025;
- Procesverbali i mbledhjes së tetë të Bordit të Drejtorëve, mbajtur më 27.08.2025;
- Procesverbali i mbledhjes së pestë të Komisionit të Auditimit, mbajtur më 25.08.2025.

Përgatitja e raporteve periodike të punës:

Janë hartuar dhe finalizuar dokumentet raportuese si në vijim:

- Raporti i Punës për muajin qershor 2025;
- Raporti i Punës për tremujorin e dytë (prill-qershor 2025);
- Raportet mujore të punës për korrik dhe gusht 2025;
- Raporti i Punës për shtator 2025, i cili përfshin aktivitetet e Zyrës së Sekretares dhe të Zyrës së Burimeve Njerëzore, në përputhje me strukturën organizative të Ndërmarrjes.

Përgatitja e vendimeve dhe dokumentacionit administrativ:

Janë përgatitur të gjitha vendimet që janë miratuar nga menaxhmenti i Ndërmarrjes, duke u siguruar që të gjitha aktet administrative të jenë në përputhje me rregullat e brendshme dhe kornizën ligjore në fuqi.

4.1. Zyra e Burimeve Njerëzore

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, Zyra e Burimeve Njerëzore ka menaxhuar dhe aprovuar pushimet e punëtorëve, përpiluar anekset e kontratave dhe shqyrtuar kërkesat e tyre, si më poshtë:

- Janë aprovuar gjithsej 131 pushime vjetore dhe 39 pushime mjekësore, përfshirë pushimet mujore të punëtorëve për korrik, gusht dhe shtator.
- Janë përpiluar Aneks kontratash për ritjen prej 36.00 euro, sipas vendimit nr. 62 të Bordit të Drejtorëve të datës 23.01.2025.
- Janë pranuar dhe shqyrtuar 7 kërkesa të punëtorëve të kompanisë.
- Është dhënë qasje në dokumente publike në lidhje me një rast anonim të sinjalizimit.

4.1.1. Struktura e të punësuarve

KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan, gjatë kësaj periudhe ka operuar me gjithsej 170 të punësuar.

Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese gjatë periudhës së TM3/2025

Numri i të punësuarve në njësitë e caktuara punuese	Gjilan	Kamenicë	Viti
	135 ¹	16	19

Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve gjatë periudhës së TM3/2025

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë gjinore	Numri i të punësuarve (meshkuj)	Numri i të punësuarve (femra)
	145	25 ²

4.1.2. Procedurat e rekrutimit dhe përmbyllja e konkurseve

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025, janë përmbyllur me sukses katër procedura të konkurseve publike për pozitat në vijim:

- Konkursi nr. 739 – 1 vend i lirë për pozitën "Drejtor Teknik";
- Konkursi nr. 833 – 5 vende të lira për pozitën "Lexues i ujëmatësve dhe shpërndarës i faturave";
- Konkursi nr. 834 – 2 vende të lira për pozitën "Teknik i shkyçjes dhe kontrollit";
- Konkursi nr. 835 – 5 vende të lira për pozitën "Punëtor i pakualifikuar – punëtor fizik në ujësjellës"³.

4.2. Zyra ligjore

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, KRU "Hidromorava" - SH.A. në Gjilan, nga ana e gjykatave kompetente ka pranuar lëndët e paraqitura në tabelën e mëposhtme.

¹ Rritja e numrit të të punësuarve nga 124 në TM2/2025 në 135 në TM3/2025 ka ardhur si rezultat i fillimit të punës për 4 punëtor fizik, 5 lexues të ujëmatësve dhe shpërndarës të faturave, 2 teknik të shkyçjes, Drejtoreshë Teknike, sipas konkurseve me numër 739, 833, 834 dhe 835 për pozitat e lartcekura. ndërsa është pensionuar z. Shaqir Ramadani me 20.07.2025,

² Rritja e numrit të të punësuarve femra nga 24 në TM2/2025 në 25 TM3/2025 ka ardhur si rezultat i rekrutimit të Drejtoreshë Teknike znj. Elhame Shefkiu Ramadani.

³ Nga kandidatët e përzgjedhur për pozitën "Punëtor i pakualifikuar", një kandidat nuk ka nënshkruar kontratën e punës dhe për pasojë, nuk ka krijuar marrëdhënie pune me Ndërmarrjen.

Tabela 5. Lëndët e pranuar nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës së TM3/2025

Lëndët e pranuar nga gjykatat kompetente			
Data	Institucioni	Nr. Aktvendimit/ Aktgjykimit	Arsyetimi
18.07.2025	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	CPK. nr. 16/25 i dt. 24.02.2025	Me Aktvendimin CPK.nr.16/25, datë 24.02.2025, Gjykata Themelore në Gjilan ka refuzuar si të pabazuar propozimin e përfaqësuesit të debitorit Ismail Ismaili nga Gjilani për plotësimin e aktvendimit të njëjtë, me të cilin kishte kërkuar që kreditori KRU "Hidromorava" Sh.A. t'i paguajë debitorit shpenzimet e procedurës përmbartimore për përpilimin e prapësimit në shumën prej 208.00 €.
29.07.2025	Gjykata e Apelit e Kosovës – Prishtinë	CAP.nr.1878/2024 i dt. 30.06.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, CAP.nr.1879/2024, datë 30.06.2025, është refuzuar si e pabazuar ankesa e kreditorit KRU "Hidromorava" Sh.A. ndaj debitorit Zuka Mavriqi nga Kamenica. Në këtë mënyrë, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega Kamenicë, PPP.nr.27/21, datë 21.08.2024, është vërtetuar, duke shfuqizuar urdhrin përmbartimor sa i përket borxhit në shumën prej 1,214.21 €, ndërsa është lënë në fuqi urdhri përmbartimor për shumën prej 21.03 €.
29.08.2025	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	C.nr. 1119/25 i dt. 27.08.2025	Me lëndën C.nr.40/2025, datë 27.08.2025, Gjykata Themelore në Gjilan ka pranuar padinë e paditësit Xhevat Salihu nga fshati Përlepnice, Komuna e Gjilanit, kundër të paditurës KRU "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan, me kërkesë për anulim të aktit administrativ që ka të bëjë me fshirjen e borxhit në shumën prej 3,692.31 €. E paditura KRU "Hidromorava" Sh.A. ka parashtruar përgjigje në padi brenda afatit ligjor, dhe kontesti është në proces të shqyrtimit gjyqësor.
04.09.2025	Gjykata e Apelit e Kosovës – Prishtinë	CAP.nr.1783/24 i dt. 05.08.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, CAP.nr.178/24, datë 05.08.2025, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e kreditorit KRU "Hidromorava" Sh.A. ndaj debitorit Isa Haxhiu nga Viti. Në këtë mënyrë, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega Viti, PPP.nr.1/2024, datë 12.08.2024, është vërtetuar, duke shfuqizuar urdhrin

			përbarimor sa i përket borxhit në shumën prej 1,058.08 €, ndërsa është lënë në fuqi urdhri përbarimor për shumën prej 114.31 €.
05.09.2025	Gjykata e Apelit e Kosovës – Prishtinë	CAP.nr.1422/24 i dt. 06.08.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, CAP.nr.1422/24, datë 06.08.2025, është aprovuar si e themeltë ankesa e kreditorit KRU "Hidromorava" Sh.A., duke prishur Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjiilan, CPK.nr.22/24, datë 29.04.2024, dhe lënda është kthyer në Gjykatën Themelore për rishqyrtim dhe vendosje të re.
05.09.2025	Gjykata e Apelit e Kosovës – Prishtinë	CAP.nr.1306/24 i dt. 06.08.2025	Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, CAP.nr.1306/24, datë 06.08.2025, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e kreditorit KRU "Hidromorava" Sh.A. ndaj debitorit Mexhid Abazi nga fshati Përlepnice, Komuna e Gjilanit. Në këtë mënyrë, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan, CPK.nr.23/2024, datë 10.05.2024, është vërtetuar, duke shfuqizuar urdhrin përbarimor sa i përket borxhit në shumën prej 983.52 €, ndërsa është lënë në fuqi urdhri përbarimor për shumën prej 136.48 €.
11.09.2025	Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti i Përgjithshëm	C.nr.1096/2025 i dt.08.09.2025	Me lëndën C.nr.1096/2025, datë 08.09.2025, Gjykata Themelore në Gjiilan ka pranuar padinë e paditësit Tefik Poroshtica nga Gjiilani, kundër të paditurës KRU "Hidromorava" Sh.A. në Gjiilan, me kërkesë për konstatim të parashkrimit të borxhit dhe pasurimit të pabazë, për shumën prej 1,858.00 €. E paditura KRU "Hidromorava" Sh.A. ka parashtruar përgjigje në padi brenda afatit ligjor, ndërsa kontesti është në proces të shqyrtimit gjyqësor.

4.3. Arkiva

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, Zyra e Arhivës, nën përgjegjësinë e Zyrtares për Arhivë, ka realizuar menaxhimin dhe administrimin e dokumentacionit të ardhur dhe të dalur në përputhje me procedurat e brendshme të Ndërmarrjes. Gjatë kësaj periudhe janë protokolluar dhe arkivuar gjithsej 545 akte nga shërbimi juridik. Në kuadër të procesit të digjitalizimit të arkivës, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 janë skanuar dhe ruajtur në format elektronik lëndat e ardhura, duke siguruar qasje të lehtë dhe ruajtje të qëndrueshme të dokumenteve; numri i lëndëve të skanuara për muajt përkatës ishte: korrik 2025 – 775 lëndë, gusht 2025 – 954 lëndë, shtator 2025 – 682 lëndë.

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e dokumenteve të protokolluara sipas njësive dhe për muajt korrik, gusht dhe shtator, duke ofruar një pamje të qartë mbi volumet e punës dhe efikasitetin e procesit të arkivimit.

Tabela 6. Numri i dokumenteve të protokolluara sipas njësive gjatë periudhës së TM3/2025

Nr.	Përshkrimi	Korrik 2025	Gusht 2025	Shtator 2025	Gjithsej TM3/2025
1.	Bordi i Drejtorëve	7	6	12	25
2.	Kryeshefi Ekzekutiv	2	4	4	10
3.	Sekretarja e Ndërmarrjes	2	5	0	7
4.	Departamenti Teknik	3	-	0	3
5.	Zyra e Auditimit	2	5	0	7
6.	Autoriteti Rregullator i Ujit (ARRU)	2	3	3	8
7.	Zyra e Prokurimit	21	23	37	81
8.	Zyra për Konsumatorë	1	-	-	1
9.	Menaxhmenti	4	7	2	13
10.	Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNj)	32	173	20	225
11.	Pëlqime	16	18	21	55
12.	Komisioni Disiplinor / Komisioni Vlerësues	4	18	9	31
13.	Ankesa / Kërkesa	4	12	16	32
14.	Gjykata Themelore / Gjykata e Apelit	2	4	5	11
15.	Komisioni i Ankesave	2	-	-	2
16.	Të tjera	8	18	8	34
	Gjithsej	112	296	137	545

5. DEPARTAMENTI FINANCIAR

5.1. Aktivitetet kryesore

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, në Departamentin Financiar janë realizuar aktivitetet:


- kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme;
- raportet ditore nga shërbimi i arkave;
- barazimi i gjendjeve bankare;
- kontimet;
- shkarkimet nga pagesat të cilat transferohen nga insitucionet mikrofinanciare dhe bankare;
- kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre;
- përgatitjet e pagave;
- plotësimi i librave të blerjes dhe shitjes sipas formës së kërkuar nga ATK-ja për muajin përkatës dhe tremujore;
- deklarimi i tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave sipas ligjit në fuqi.

5.2. Shqyrtimi i performances operative dhe financiare

5.2.1. Prodhimi i ujit në m³

Prodhimi i ujit në m³ për TM3/2025 në krahasim me TM3/2024 ka ulje për 0.02%, ndërsa sa i përket arritjes së caktit të planifikuar është përmbushr vetëm për 93.83%.


Tabela 7. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m³



5.2.2. Faturimi i ujit në m³

Faturimi i ujit në m³ për TM3/ 2025 në krahasim me TM3/2024 ka shënuar ulje për 3.59%, ndërsa sa i përket caktut të planifikuar, është nën plan për 12.91%.


Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m³



5.2.3. Faturimi i ujit në euro (€)

Faturimi i ujit në euro (€) në TM3/2025 në krahasim me TM3/2024 ka rritje 12.08%, ndërsa sa i përket caktut të planifikuar, është nën plan për 11.87%.


Tabela 9. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)



5.2.4. Arkëtimi i ujit/€

Arkëtimi i ujit për TM3/2025 në krahasim me TM3/2024 ka shënuar ulje për 0.24 %. Arkëtimi i e borxheve të vjetra ka ndikuar në rritje të normës së arkëtitimit, ndërsa sa i përket realizimit të planit, është nën plan për 5.57%.


Tabela 10. Paraqitja grafike e arkëtitimit të ujit/€



5.2.5. Përqindja e arkëtim

Përqindja e arkëtitimit nga faturimi për TM3/2025 në krahasim me TM3/2024 ka shënuar rritje për 12.8 %, ndërsa plani është tejkaluar për 6.91%.

Tabela 11. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtitimit



5.2.6. Shpenzimet operative

Shpenzimet në TM3/2025 në krahasim me TM3/2024, kanë shënuar rritje për 21.55 %. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të parashikuara janë për 8.49 % më të larta nga planifikimi.

Tabela 12. Paraqitja grafike e shpenzimeve në €




Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për region TM3/2025 dhe TM3/2024 dhe plani TM3/2025

Indikatorët - Regjion	TM3/2025	TM3/2024	Realizimi 2025/2024	Trendi 2025/2024	Plani TM3 /2025	Realizimi i planit [%]	Trendi 2025 me Planin
1. Prodhim i ujit [m ³]	2,542,891	2,543,372	99.98	neg	2,710,000	93.83	neg
2. Faturimi [m ³]	1,258,436	1,305,306	96.41	neg	1,445,000	87.09	neg
3. Uji i pafaturar [m ³]	1,284,455	1,238,066	103.75	neg	1,265,000	98.49	neg
4. Faturimi [€]	802,659	716,123	112.08	poz	910,726	88.13	neg
5. Arkëtimi [€]	831,649	833,668	99.76	neg	880,674	94.43	neg
6. Shkalla e arkëtimit [%]	103.61 ⁴	116.41	89.00	neg	96.70	107.15	poz
7. Shpenzimet operative [€] ⁵	665,622	547,596	121.55	neg	613,528	92.17	neg
8. Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	46,202	43,017	107.40	poz	43,143	107.09	poz
9. Numri i konsumtorëve me ujëmatës[nr]	42,038	38,983	107.84	poz	40,505	103.78	poz
10. Numri i konsumtorëve me konsum zero [nr]	20,829	18,440	112.96	neg	18,700	89.78	neg
11. Konsumatorë të rinj [nr]	1,692	350	483.43	poz	360	470.00	poz
12. Numri i konsumtorëve aktiv [nr]	42,186	39,141	107.78	poz	40,624	103.85	poz
13. Numri i konsumtorëve pa matje [nr]	148	158	93.67	poz	60	40.54	neg
14. Faturimi i ujit me ujëmatës [m ³]	1,234,867	1,271,815	97.09	neg	1,440,810	85.71	neg
15. Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës [%]	99.65	99.60	100.05	poz	99.71	99.94	neg
16. UPF në [%]	50.51	48.68	103.77	neg	46.68	92.41	neg
17. Norma e mbulimit operativ	1.25	1.52	82.07	neg	1.44	87.04	neg
18. Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	137,037	168,527	81.31	neg	297,198	46.11	neg
19. Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	166,027	286,072	58.04	neg	267,146	62.15	neg
20. Kostoja për Njësi [€/m ³]	0.26	0.22	121.58	poz	0.23	86.49	neg
21. Efikasiteti i stafit ['000 kons]	4.03	4.24	95.02	neg	4.43	109.95	poz

⁴ Norma e arkëtimit është rezultat i rritjes së faturimit në €, ndikimi i rritjes së tarifës pasi që faturimi i ujit ka rënë.

⁵ Rritja e shpenzimeve të energjisë ka ndikur në rritje nga ndryshimi i furnizimit në tregun e lirë.

Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine Operative të Gjilanit TM3/2025 dhe krahasimi me TM3/2024

Indikatorët - Gjilan	TM3/2025	TM3/2024	Realizimi 2025/2024	Trendi 2025/2024
1. Prodhimi i ujit (m ³)	1,802,006	1,838,013	98.04	neg
2. Faturimi (m ³)	975,252	1,031,462	94.55	neg
3. Uji i pafaturar (m ³)	826,754	806,551	102.50	neg
4. Faturimi (€)	630,376	571,837	110.24	poz
5. Arkëtimi (€)	684,542	693,244	98.74	neg
6. Shkalla e arkëtimit (%)	1.09	1.21	89.57	neg
7. Shpenzimet (€) ⁶	521,027	419,144	124.31	neg
8. Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	34,225	32,819	104.28	poz
9. Numri i konsumtorëve me ujëmatës (nr)	31,885	30,543	104.39	poz
10. Numri i konsumtorëve me konsum zero (nr)	15,107	13,969	108.15	neg
11. Konsumtorë të rinj (nr)	261	179	145.81	poz
12. Numri i konsumtorëve aktiv (nr)	31,933	30,603	104.35	poz
13. Numri i konsumtorëve pa matje (nr)	48	60	80.00	poz
14. Faturimi i ujit me ujëmatës (m ³)	973,234	1,020,687	95.35	neg
15. Proporcioni i konsumtorëve me ujëmatës (%)	99.85	99.80	100.05	poz
16. UPF në (%)	45.88	43.88	104.55	neg
17. Norma e mbulimit operativ	1.31	1.65	79.44	neg
18. Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	109,349	152,693	71.61	neg
19. Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	163,515	274,100	59.66	neg
20. Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.29	0.23	126.79	neg
21. Efikasiteti i stafit ('000 kons)	4.10	4.18	98.14	poz

⁶ Rritje e shpenzimeve nga periudha e kaluar në vlerë prej 90,344 € një NJO Gjilan, shpenzimet e kemikateve në vlerë 6,016 € dhe personelit rritjes e stafit 41,159 €, shpenzimet e tjera operative kanë ulje.

Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësine Operative të Kamenicës TM3/2025 dhe krahasimi me TM3/2024

Indikatorët - Kamenicë		TM3/2025	TM3/2024	Realizimi 2025/2024	Trendi 2025/2024
1.	Prodhimi i ujit (m ³)	296,445	256,719	115.47	poz
2.	Faturimi (m ³)	138,903	136,795	101.54	poz
3.	Uji i pafaturar (m ³)	157,542	119,924	131.37	neg
4.	Faturimi (€)	81,572	70,000	116.53	poz
5.	Arkëtimi (€)	79,938	80,688	99.07	neg
6.	Shkalla e arkëtimit (%)	98.00	115.27	85.02	poz
7.	Shpenzimet (€) ⁷	75,527	68,543	110.19	neg
8.	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	6,790	5,402	125.69	poz
9.	Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr)	5,649	4,290	131.68	poz
10.	Numri i konsumatorëve me konsum zero (nr)	3,303	2,066	159.87	neg
11.	Konsumatorë të rinj (nr)	1326	32	4143.75	neg
12.	Numri i konsumatorëve aktiv (nr)	5,649	4,290	131.68	poz
13.	Numri i konsumatorëve pa matje (nr) ⁸	-	-	-	-
14.	Faturimi i ujit me ujëmatës (m ³)	138,903	136,795	101.54	poz
15.	Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës (%)	100.00	100.00	100.00	poz
16.	UPF në (%)	53.14	46.71	113.76	neg
17.	Norma e mbulimit operativ	1.06	1.18	89.91	neg
18.	Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	6,045	1,457	414.89	poz
19.	Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	4,411	12,145	36.32	neg
19.	Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.25	0.27	95.42	poz
20.	Efikasiteti i stafit ('000 kons)	3.36	3.96	84.94	poz

⁷ Rritja e shpenzimeve të energjisë, vlera 5,158€ dhe shpenzime pagave 3,424.00€.

⁸ Nj.O. Kamenicë nuk ka konsumatorë pa matje.

Tabela 16. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative në Vitet për TM3/2025, krahasimi me TM3/2024

Indikatorët - Viti	TM3/2025	TM3/2024	Realizimi 2025/2024	Trendi 2025/2024
1. Prodhimi i ujit (m ³)	444,440	448,640	99.06	neg
2. Faturimi (m ³)	144,281	137,049	105.28	poz
3. Uji i pafaturar (m ³)	300,159	311,591	96.33	poz
4. Faturimi (€)	90,711	74,286	122.11	poz
5. Arkëtimi (€)	67,169	59,736	112.44	poz
6. Shkalla e arkëtimit (%)	74.05%	80.41%	92.08	neg
7. Shpenzimet (€) ⁹	69,068	59,909	115.29	neg
8. Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	5,187	4,796	108.15	poz
9. Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr)	4,504	4,150	108.53	poz
10. Numri i konsumatorëve me konsum zero (nr)	2,419	2,405	100.58	neg
11. Konsumatorë të rinj (nr)	105	139	75.54	neg
12. Numri i konsumatorëve aktiv (nr)	4,604	4,248	108.38	poz
13. Numri i konsumatorëve pa matje (nr)	100	98	102.04	neg
14. Faturimi i ujit me ujëmatës (m ³)	122,730	114,333	107.34	poz
15. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	97.83	97.69	100.14	poz
16. UPF në (%)	67.54	69.45	97.24	neg
17. Norma e mbulimit operativ	0.97	1.00	97.53	neg
18. Diferenca faturimi/shpenzimet operative €	21,643	14,377.00	150.54	poz
19. Diferenca arkëtimi/shpenzimet operative €	-1,899	-173	1098.13	neg
20. Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.16	0.13	116.38	neg
21. Efikasiteti i stafit ('000 kons)	4.34	4.47	97.12	poz

⁹ Rritje e shpenzimeve të energjisë 6,964.00€, shpenzimet e pagave në vlerë prej 1,734.00€ dhe kemikatet 1,474.00€.

Tabela 17. Treguesit – të hyrat dhe shpenzimet operative për TM3/2025 dhe krahasimi me TM3/2024

Shpenzimet - Regjion	TM3/2025	TM3/2024	Realizimi 2025/2024
Shpenzimet e pagave (personeli)	418,472.00	373,916.00	44,556.00
Shpenzimet e energjisë	173,026.00	81,014.00	92,012.00
Shpenzimet për derivate	10,909.00	10,188.00	721.00
Shpenzimet për kemikate	14,706.00	9,886.00	4,820.00
Shpenzimet për analiza të ujit	3,701.00	4,559.00	(858.00)
Ngarkesa për shërbime të ARRU-së MMPH	7,415.00	4,686.00	2,729.00
Shpenzimet të kontraktuara	737.00	634.00	103.00
Shpenzimet e qirasë	2,143.00	2,725.00	(582.00)
Shpenzimet e materialit të konsumueshme	1,575.00	1,027.00	548.00
Ngarkesa për shërbime të SHUKOS-it	1,550.00	3060.00	(1,510.00)
Shpenzime për mirëmbajtje pajisjeve	6,661.00	14,937.00	(8,276.00)
Shpenzimet për mirëmbajtje rrjetit uje dhe kanalizim	4,679.00	8,030.00	(3,351.00)
Shpenzimet e reprezentacionit/udhëtime zyrtare	8,355.00	2,611.00	5,744.00
Shpenzimet për telefon dhe internet	2,617.00	1,954.00	663.00
Shpenzimet e provizionit/përmbaruesit	706.00	2308.00	(1,602.00)
Shpenzimet e materialit administrativ	1,997.00	1,392.00	605.00
Shpenzime të tjera direkte	6,373.00	31,753.00	(25,380.00)
Gjithsej	665,622.00	547,596.00	110,942.00

5.3. Pasqyrat Financiare - shtator 2025/2024

Pasqyra e pozitës financiare (deri më 30 shtator 2025)

	Shënimi	TM3/2025 (€)	TM3/2024 (€)
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	1	1,114,796.00	918,412.00
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	2	3,155,212.00	3,395,895.00
Stoqet	3	475,187.00	446,535.00
Pasuritë e tjera afatshkurtra	4	107,960.00	72,839.00
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		4,853,155.00	4,833,681.00
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	46,870,132.00	7,048,048.00
Prona investuse		-	-
Investimet në vijim		1,422,625.00	2,030,915.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		49,292,757.00	9,519,356.00
Gjithsej pasuritë		54,145,912.00	14,353,037.00
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	6	177,688.00	27,153.00
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		-	-
Tatimet e pagueshme aktuale		-	-
Të hyrat e shtyra		-	-
Provizionet afatshkurtra			
Detyrimet e tjera afatshkurtra	7	130,004.00	104,669.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra	8	307,692.00	131,822.00
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjate		-	-
Provizionet afatgjate		-	-
Detyrimet ndaj lizingut pjesa afatgjate			

Detyrimet nga e shtyra (grantet)	9	6,813,118.00	6,280,646.00
Detyrime tjera afatgjate		-	-
Gjithsej detyrimet afatgjate		6,813,118.00	6,280,646.00
Gjithsej detyrimet		7,120,810.00	6,412,468.00
EKUITETI			
Kapitali aksionar	10	8,074,519.00	8,074,519.00
Fitimet/humbjet e bartura		68,965.00	(133,950.00)
Rezervat e tjera		38,881,918.00	-
Gjithsej ekuiteti		47,025,102.00	7,940,569.00
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		54,145,912.00	14,353,037.00

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
(deri më 30 shtator 2025)

	Shënimi	TM3/2025 (€)	TM3/2024 (€)
TË HYRAT	11	792,055.00	713,546.00
Të hyrat e tjera		32,643.00	18,484.00
Të hyrat nga grantet		119,485.00	108,780.00
Total të hyrat		944,183.00	840,840.00
Shpenzimet e shpërndarjes (personelit)	12	(418,472.00)	(373,916.00)
Shpenzimet administrative (zhvlerësimit)	13	(187,947.00)	(166,643.00)
Shpenzimet energjisë elektrike		(173,026.00)	(81,014.00)
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(11,340.00)	(22,967.00)
Shpenzimet e kimikateve/derivate/analiza të ujit		(29,316.00)	(24,233.00)
Shpenzimet e tjera operative		(33,468.00)	(45,466.00)
Total shpenzimet		(853,569.00)	(714,239.00)
Fitimi /(humbja) operative		90,614.00	126,601.00
Shpenzimet financiare		-	-
Të ardhurat financiare		-	-
Fitimi/(humbja para tatimit)		90,614.00	126,601.00
SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM		-	-

Fitimi /(humbja) i/e periudhës	14	90,614.00	126,601.00
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi			
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të periudhës		-	-
Gjithsej të ardhurat /(humbjet) gjithëpërfshirëse të periudhës		-	-

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
(për vitin që përfundon më 30 shtator 2025)

	Kapitali aksionar (€)	Fitimet e mbajtura (€)	Rezervat e tjera (€)	Gjithsej (€)
Gjendja më 30 shtator 2025	8,074,519.00	68,965.00	38,881,618.00	47,025,102.00
Fitimi/(humbja) i/e vitit (TM3/2025)	-	90,614.00	-	90,614.00
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividentat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarje e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 30 shtator 2025	8,074,519.00	159,579.00	38,881,618.00	47,115,716.00

Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 30 shtator 2025

Shënimi	TM3/2025 (€)	TM3/2024 (€)
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE		
(Fitimi)/(humbja) i/e periudhës	90,614.00	126,601.00
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave	-	-
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	187,947.00	166,643.00
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme	-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	38,881,618.00	-
Të ardhurat financiare	-	-
Shpenzimet financiare	-	-
(Fitimi)/(humbja) nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
 Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative	 3,916,179.00	 293,244.00
(Rritja)(zvogëlimi) në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	240,683.00	83,830.00
(Rritja)/(zvogëlimi) në stoke	(28,652.00)	(118,379.00)
(Rritja)/(zvogëlimi) në pasuritë e tjera	(35,121.00)	(9,554.00)
(Rritja) / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	150,535.00	59,388.00
(Rritja)/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera	25,335.00	70,802.00
(Rritja)/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera nga grantet	532,472.00	1,485,871.00
 Tatimi në fitim i paguar	 -	 -
Interesi i paguar	-	-
 Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	 40,045,431.00	 1,865,202.00
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTUESE		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(39,849,047.00)	(1,664,448.00)
Arkëtimet për shitjen e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	-	-
Interesi i arkëtuar	-	-
Divdentat e paguara	-	-

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(39,849,047.00)	(1,664,448.00)
--	-----------------	----------------

RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE

Deponimet e kapitalit shtesë	-	-
Dividentat e paguara	-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	-	-
Pagesat e lizingut financiar	-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	-	-

(Rritja) /(zvogëlim) neto e parasë dhe ekuivalentëve të parasë	196,384.00	200,754.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës	918,412.00	717,658.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës	1,114,796.00	918,412.00

5.3.1. Shpalosje e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare deri më 30 shtator 2025

Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Tabela 18. Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në banka dhe në arkë

Përshkrimi	TM3/2025	TM3/2024
Paratë në arka	1,105.00	1,173.08
Paratë në banka	1,113,691.00	911,731.00
Gjithsej	1,114,796.00	912,904.00

Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera

Tabela 19. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera

	TM3/2025	TM3/2024
Llogaritë e arkëtueshme	7,787,829.00	7,970,554.00
Provizioni i llogarive - amvisëri	3,626,098.00	3,607,879.00

Provizioni i llogarive – biznes	378,696.00	378,696.00
Provizioni i llogarive – Institucione	447,985.00	447,985.00
Lejimet e bartura për shërbimet	152,016.00	152,016.00
Total provizioni	4,463,645.00	4,612,337.00
Neto të arkëtueshmet	3,155,212.00	3,358,217.00

Shënimet shpjeguese 3. Stoqet

Ndërmarrja përdor metodën e vlerësimit të stoqeve sipas sistemit të vazhdueshëm. Regjistrimi bëhet në momentin e pranimit të e-mailit me metodën e pranimit të mallit, me metodën e së cilës përcaktohet kosto e stoqeve sipas vlerës mesatare.

Tabela 20. Stoqet

Përshkrimi - stoqet	TM3/2025 Vlera në €	TM3/2024 Vlera në €
Depo Kamenicë	51,741.33	51,741.33
Depo Baja – kimikale	246.02	246.02
Depo e mbyllur Gjilan	199,850.01	199,850.01
Depo e hapur Gjilan	62,964.21	34,312.21
Depo administrative	368.55	368.55
Depo materiale jo funksionale	13.51	-
Depo tek penda	37,371.59	37,371.59
Depo Përlepnice – Gjilan	60,105.52	48,315.32
Depo Viti	58,942.22	58,942.22
Material depo Velekincë/Gjilan	6,181.86	6,181.86
Material revers	2,428.38	2,428.38
Depo punëtorja e ujëmatësve	6,763.67	6,763.67
Gjithsej	475,187.00	446,535.00

Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta

Tabela 21. Pasuritë tjera afatshkurta

	TM3/2025	TM3/2024
Parapagimet e marra	64,738.00	64,738.00
Paradhënie të pranuar	8,100.00	8,101.00
Gjithsej	107,960.00	72,839.00

Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata - pronat, impiantet dhe pajisjet

Tabela 22. Pronat, impiantet dhe pajisjet

Emërtimi	TM3/2025	TM3/2024
Toka	5,270,695.00	1,902,000.00
Ndërtesa	15,933,532.00	4,886,622.00
Rrjeti i ujësjellësit, instalime teknike, makineri, pajisje	29,359,058.00	5,705,131.00
Mjete transporti	603,566.00	418,427.00
Mobile dhe pajisje zyre	395,482.00	2,299,437.00
Pajisje informative	119,965.00	78,775.00
Rrjeti i kanalizimit	5,716,844.00	1,029,710.00
Investime në vijim		37,310.00.00
Të tjera		35,482.00
Gjithsej	57,417,943.00	17,298,042.00

Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet

"Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit në Dobërçan - Gjilan". Ndërrimi (zëvendësimi) i gypave të ujësjellësit dhe ri kycjet individuale DN80 mm AC deri DN 200 mm PE.

Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit, hapjes së puseve dhe ndërtimit të rrjetit në Berivojcë-Aneks Kontratë.

Kycjet (e rrugëve apo shtëpive individuale përgjetë kolektorit fshati Livoç i Epërm Livoç i Ulët-Kodra e Thatë - gjatësi 800m).

Ndërtimi dhe rehabilitimi i rezervuareve në Kamenicë.

Ndërrimi i gypit të rrjetit të ujërave të kanalizimit në rrugën "Abdullah Tahiri" me gjatësi L=450 m- ri tender.

"Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës".

"Impianti i ujërave të zeza - ITUZ".

"FLOWS-CS-CQ-09".

"Hartimi, ndërrimi i gypave dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, brenda zonës së shërbimit".

Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM3/2025

Tabela 23. Llogaritë e pagueshme

Emërtimi i Furnitorit

KEK – Sh.A

"TEUTA M" Sh.P.K.

"XERXA" Sh.P.K.

MMPH

"INTERLAB" Sh.P.K.

"SEYKOS" Sh.P.K.

HIB PETROL

Furnitorë të tjerë

Gjithsej

Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet tjera afatshkurtra

Tabela 24. Detyrimet tjera afatshkurtra

Përshkrimi	TM3/2025	TM3/2024
Llogaritë e pagushme	177,688.07	27,153.00
Detyrimet tjera afatshkurta	130,004.00	104,669.00
Gjithsej	307,692.00	131,822.00

Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyra/grantet

Tabela 25. Të hyrat e shtyra /grantet

Përshkrimi	TM3/2025	TM3/2024
Të hyrat e shtyra në fillim të vitit	6,813,113.00	6,280,646.00
Të hyrat e shtyra meë30 shtator	6,813,113.00	6,280,646.00

Shënimet shpjeguese 10. Ndryshimi në ekuitet

Tabela 26. Ekuiteti

	TM3/2025	TM3/2024
Ekuiteti më 30 shtator 2024	47,025,102.00	7,940,569.00
	47,025,102.00	7,940,569.00

Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat

Tabela 27. Të hyrat

	TM3/2025	TM3/2024
Të hyrat nga shitja e ujit	792,055.00	713,546.00
Të hyrat nga shërbimet	32,643.00	18,484.00
Të hyrat nga grantet	119,485.00	108,780.00
Të hyrat totale	944,183.00	840,840.00

Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes

Tabela 28. Shpenzimet e shpërndarjes

	TM3/2025	TM3/2024
Shpenzimet e personelit	(418,472.00)	(373,916.00)

Shënimet shpjeguese 13. Shpenzimet administrative të tjera

Tabela 29. Shpenzime administrative të tjera

	TM3/2025	TM3/2024
Shpenzimet administrative (zhvlerësimit)	(187,947.00)	(166,643.00)
Shpenzimet energjisë elektrike	(173,026.00)	(81,014.00)
Shpenzimet e mirëmbajtjes	(11,340.00)	(22,967.00)
Shpenzimet e kimikateve/derivate/analiza të ujit	(29,316.00)	(24,233.00)
Shpenzimet e tjera operative	(33,468.00)	(45,466.00)
Total shpenzimet	(435,397.00)	(340,323.00)

Shënimet shpjeguese 14. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit

Tabela 30. Fitimi (humbja) para tatimit

30.09.2025	90,614.00€
30.09.2024	126,601.00€

Shpalosja e ndryshimeve në ekuitet

Tabela 31. Ndryshimet në ekuitet

Kapitali aksionar	8,049,519.00
Fitimi i vitit paraprak	126,601.00
Fitimi/humbjet e bartura	68,965.00
Fitimi/humbja e vitit aktual	90,614.00
Fitimi/humbjet e bartura	159,579.00

6. ZYRA E PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, ka pranuar disa kërkesa me shkrim, për furnizime, shërbime dhe punë, nga njësitë përkatëse të cilat janë inicuar nga menaxhmenti i Ndërmarrjes, ku këto kërkesa pastaj janë proceduar varësisht prej prioriteteve dhe konform rregullave të prokurimit.

Tabela 32. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM3/2025 - vlerë minimale

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera
31.07.2025	Furnizim me akumulator për makinerinë e Ndërmarrjes dhe rregullimi i automjeteve Toyota dhe Caddy	"UNIVERSAL" Sh.P.K.	880.00 €
04.08.2025	Furnizim me fatura për konsumatorë	PIKA 5A Sh.P.K.	495.00 €
14.08.2025	Furnizim me gyp për kamionet të kanalizimit	Gazmend Bojku B.I.	988.80€

Tabela 33. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM3/2025 - "procedurë e hapur - kuotim i çmimit"

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera
09.09.2025	Riparimi i gjeneratorit elektrik në FPU Përlepnice	"Power System" Sh.P.K.	8,220.00€
09.09.2025.	Furnizimi dhe instalimi i kamerave të sigurisë në zyrën qendrore, FPU Letnicë dhe Guri i Hoxhës	"Fati Security" Sh.P.K.	2,606.00€
04.09.2025.	Furnizim dhe Instalim me Kondicioner Inverter	"Infinit" Sh.P.K.	2,235.00€

Tabela 34. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM3/2025 - procedurë e hapur - vlerë e mesme

Data	Lloji i kontratave	Operatori ekonomik	Vlera:
14.08.2025	Ndërimi i gypit të rrjetit të ujërave të kanalizimit në Rr. "Abdullah Tahiri" me gjatësi L=450m - ri tender	Grup i Operatorëve Ekonomik "KUSHTRIMI NM" Sh.P.K. dhe "ENGINEERING RK" Sh .P.K.	57,900.00 €

7. DIVIZIONI PËR CILËSI TË UJIT

7.1. Cilësia e ujit

Raporti i tremujorit të tretë të vitit 2025 jep një pasqyrë të përmblendhur të cilësisë së ujit të pijshëm nëpër të gjitha zonat e KRU "Hidromorava" Sh.A. Bazuar në rezultatet e analizave fiziko - kimike dhe mikrobiologjike të punura në laboratorin qendror të KRU "Hidromorava", në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjilan - QRSHP si dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike - IKSHPK, cilësia e ujit gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, ka qenë rreth 99% në përputhje me vlerat parametrike për ujin e pijshëm.

Duke u bazuar në Planin për Monitorim të Cilësisë së Ujit, në KRU "Hidromorava", monitorimi i cilësisë së ujit bëhet nëpërmjet dhjetë zonave të ndara sipas karakteristikave të ujit.

1. **Zona HM 01** - burimi "Guri i Hoxhës" dhe "Liqeni i Përlepnicës", kjo është zona më e madhe në KRU "Hidromorava";
2. **Zona HM 02** - burimet e ujit në "Pasjan", "Fabrika e Përpunimit të Ujit në Velekincë";
3. **Zona HM 03** - burimi "Baja";
4. **Zona HM 04** - zonat rurale (burimet e ujit në Malishevë, Zhegër, Doberqan, Llovcë dhe Bilinicë);
5. **Zona HM 05** - Letnica, Fabrika për Përpunimin e Ujit në Letnicë;
6. **Zona HM 06** - burimet e ujit në fshatin Pozharan;
7. **Zona HM 07** - burimet e ujit në Kamenicë, fshatin Karaçevë dhe Shipashnicë;
8. **Zona HM 08** - burimet e ujit në fshatin Topanicë dhe Koretin;
9. **Zona HM 09** - burimet e ujit në fshatin Makresh, Novoberdë;
10. **Zona HM 10** - burimet e ujit në Ranillug dhe fshatin Ropotovë.

Parametrat të cilat kontrollohen për ta vërtetuar cilësinë e ujit janë:

- **Parametrat fizik të cilët janë punuar janë:** era, ngjyra, shija, përqueshmëria elektrike, turbullira fortësia e ujit.
- **Parametrat kimik të cilët janë punuar:** pH, klori residual, amoniaku, nitritet, nitratet, sulfatet, hekuri, mangani, kalciumi, magnezi, shpenzimi i KMnO_4 , fosfatet, kloruret, alumini.
- **Parametrat mikrobiologjik të cilët janë punuar:** numri i tërësishëm i baktereve koliforme në 100 ml, bakteret koliforme me prejardhje fekale në 100 ml, numri i tërësishëm i baktereve të gjalla në 1 ml në 37 gradë celsius, streptokoket me prejardhje fekale në 100ml.

Në baza tre mujore punohen edhe metalet e rënda, trehalometanet THM, si dhe karboni total organik TOC.

Në përgjithësi, cilësia e ujit në KRU "Hidromorava" Sh.A., gjatë muajve prill, maj dhe qershor i ka përbushur standardet e kërkuara për ujë të pijes, ku në shumicën e mostrave kemi pasur përputhje të vlerave parametrike për ujë të pijes, përveç në disa raste të rralla që kemi pasur mospërputhje të vlerave parametrike për të cilat janë ndërmarrë masa të menjëhershme dhe konsumatorët janë informuar me kohë përmes mjeteve të informimit.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 kemi pasur mospërputhje të vlerave parametrike në zonat si në vijim:

Muaji korrik 2025

Gjatë këtij muaji janë evidentuar disa mospërputhje të vlerave parametrike në stacionet e mëposhtme:

- **HM05 – ITU Letnicë:**

Për shkak të reshjeve të dendura atmosferike, është regjistruar ngritje e turbullirës së ujit mbi normat e lejuara për konsum. Për shkak të pamundësisë së trajtimit të ujit deri në vlera brenda normave, uji u ndalua përkohësisht deri në stabilizimin e situatës. Konsumatorët u njoftuan përmes faqes zyrtare të kompanisë.

- **HM06 – Stacioni i Pompimit, Sadovinë:**

Ulja e nivelit të ujit në burim shkaktoi një ngritje të lehtë të turbullirës. Mostra e ujit u përsërit dhe të gjitha parametrat, përfshirë turbullirën, rezultuan brenda normave të lejuara.

- **HM07 dhe HM08 – Rajoni i Kamenicës:**

Si pasojë e thatësisë dhe rënies së nivelit të ujit në SP Koretin, janë shënuar luhatje të disa parametrave. Për stabilizim, uji u grumbullua dhe u kryen reduktime të kontrolluara të rrjedhjes, duke siguruar që parametrat të rikuperohen brenda normave.

Në SP Kopërnice, për shkak të rënies së nivelit të ujit, u regjistrua një ngritje e lehtë e manganit; për këtë u ndërmor rritja e sasisë së klorit për oksidimin e manganit. Mostra e përsëritur rezultoi brenda normave.

- **HM10 – Stacioni i Pompimit, Novobërdë:**

Gjatë analizave të ujit u vërejt ngritje e turbullirës; konsumatorët u njoftuan përmes faqes zyrtare.

- **HM10 – Stacioni i Pompimit, Ranillug:**

Në këtë stacion është konstatuar mungesë e klorit të lirë dhe prezencë e baktereve. Problemi u identifikua dhe u zgjidh menjëherë nga operatori, duke rikthyer parametrat brenda normave të lejuara.

Vërejtje e përgjithshme për korrikun: Shumica e mospërputhjeve janë regjistruar në stacionet e veçanta të pompimit, të cilat furnizohen me ujë nga pusete nëntokësore. Thatësia gjatë periudhës dhe kërkesat e larta për konsum kanë shkaktuar shfrytëzim të madh të burimeve, duke ndikuar në ndryshimin e disa parametrave. Situata është menaxhuar në mënyrë efektive.

Muaji gusht 2025

Gjatë muajit Gusht, të gjitha mostrat e ujit u morën sipas Planit të Monitorimit të Cilësisë së Ujit dhe nuk u regjistruan mospërputhje parametrike.

Në stacionet e pompimit në Letnicë (Shoshare) dhe Llovçë, për shkak të problemeve teknike, nuk ishte e mundur dozimi i klorit; konsumatorët u njoftuan përmes faqes zyrtare.

Muaji shtator 2025

Pas uljes së nivelit të ujit në Liqenin e Perlepnices, u bë e nevojshme ndryshimi i nivelit të marrjes së ujit. Si pasojë, në ujin e papërpunuar u evidentua një ngritje e lehtë e manganit mbi nivelin e zakonshëm.

Për të garantuar cilësinë e ujit të pijshëm dhe respektimin e standardeve ligjore, filloi dozimi i ujit me Permanganat Kaliumi në procesin e trajtimit. Pas përshtatjes së nivelit mesatar të liqenit, është konstatuar vetëm një mostër me koncentrim të lehtë të manganit në rezervuarin e ujit të përpunuar; në rrjetin shpërndarës që furnizon qytetin, të gjitha vlerat kanë qenë brenda normave të lejuara.

Ky proces është monitoruar vazhdimisht, ndërmarrja ka ndërmarrë masat e nevojshme për trajtim adekuat dhe dozimi i Permanganatit Kalium vazhdon ende në doza të ulëta. Të gjitha mostrat në rezervuarin kryesor dhe në rrjetin shpërndarës në zonën HM01 plotësojnë standardet për ujë të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ UA Nr.10/2021.

8. DEPARTAMENTI TEKNIK

8.1 Aktivitetet kryesore të drejtorit teknik

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, janë realizuar këto aktivitete:

- **Ankesat e konsumatorëve pa rrjet ujësjellësi:** Në bashkëpunim me menaxherin e rrjetit të ujësjellësit janë shqyrtuar kërkesat e konsumatorëve për kycje në rrjetin ekzistues të ujësjellësit dhe janë identifikuar mundësitë teknike për realizim.
- **Takim me menaxherët e divizioneve teknike për hartimin e Planit të Menaxhimit të UM:** Në vijim të rekomandimeve nga raporti i besueshmërisë i ARRU-së, është mbajtur takim koordinues ku është rënë dakord që komisioni përkatës të mbajë mbledhje dhe të ndajë detyrat sipas përgjegjësi të secilit zyrtar për finalizimin e planit.
- **Përgatitja e projekteve për Planin e Biznesit 2026 dhe Planin Trevjeçar 2026-2028:** Divizioni i Planifikimit, në bashkëpunim me divizionet tjera, ka filluar përgatitjen e projekteve prioritare që do të përfshihen në këto plane zhvillimore.
- **Përgatitja e raportit mujor për muajt korrik, gusht dhe shtator:** Janë mbledhur dhe përmbledhur raportet e menaxherëve të divizioneve teknike dhe njësive operative në një raport unik, i cili është dorëzuar te Sekretarja e Ndërmarrjes.
- **Raporti për projektin e Cernicës:** Me kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv është hartuar raporti për gjendjen aktuale të projektit, janë evidentuar ndryshimet e propozuara nga menaxheri dhe mbikëqyrësi i projektit, si dhe janë dhënë rekomandimet për hapat e mëtejshëm.
- **Takime javore me njësitet operative Viti dhe Kamenicë, si dhe me menaxherët e divizioneve teknike:** Janë diskutuar çështjet operative, defektet e ndodhura gjatë javës dhe detyrat e planifikuara për periudhën pasuese.
- **Vizita në Njësinë Operative të Vitisë:** Në bashkëpunim me Zyrën e Planifikimit dhe përgjegjësin e njësive, është analizuar situata e mungesës së ujit gjatë verës dhe humbjeve të mëdha në rrjet. Është vizituar rezervuari në Letnicë dhe gypi transportues për identifikimin e lokacionit të vendosjes së UM zonale.
- **Takime ditore (brief) me menaxherët e divizioneve:** Janë zhvilluar takime të përditshme për koordinimin e aktiviteteve operative dhe menaxhimin e defekteve në terren.
- **Projekti i Cernicës – takim koordinues:** Është zhvilluar takim me Kryeshefin Ekzekutiv, menaxherin e projektit, mbikëqyrësin dhe Zyrtarin Kryesor Financiar për përcaktimin e hapave të mëtejshme në realizimin e projektit.
- **Vizitë në terren në "Fshatin e Lumtur":** Me kërkesë të Kryetarit të Komunës z. Hyseni, bashkë me menaxherin dhe inxhinierin e Zyrës së Planifikimit, është kryer vizita për të shqyrtuar mundësinë e kycjes së fshatit në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- **Aktivitete për procesin tarifor:** Në bashkëpunim me menaxherin e Divizionit të Planifikimit dhe menaxherët tjerë, janë përgatitur projektet që planifikohet të implementohen gjatë periudhës 2026-2028, përfshirë përshkrimet, arsyeshmërinë dhe paramasat me përllogaritje.
- **Aktivitetet për Planin e Biznesit:** Është punuar paralelisht në përgatitjen e projekteve përfshirë në Planin e Biznesit 2026 dhe në Planin Trevjeçar, me fokus në projektet prioritare dhe ato me financim të kombinuar.
- **Vizita në terren për ndërprerjet e ujit:** Në bashkëpunim me Koordinatorin e Humbjeve të Ujit dhe menaxherin e Zyrës për Konsumatorë, është realizuar vizita në rrugët "Naser Azemi" dhe "Rr. 13, Dardania II" për të verifikuar problemet e raportuara.

- **Takim me kompaninë dizajnuese të projektit të Cërnicës:** Është mbajtur takim me projektuesin, menaxherin dhe mbikëqyrësin për shqyrtimin dhe aprovimin e ndryshimeve të propozuara në projekt.
- **Takim me Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Gjilanit:** Është diskutuar për dokumentacionin që duhet përgatitur nga zyrtarët e Hidromoravës si pjesë e procesit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Tabela 35. Takimet e Drejtorit Teknik me institucionet relevante dhe operator ekonomik, gjatë TM3/2025

Nr.	Institucioni	Data	Qëllimi i takimit
1.	ARRU	21.08.2025	Është mbajtur takim me Drejtoreshën dhe Zëvendës Drejtorin e ARRU-së, ku është diskutuar për procesin tarifor trevjeçar për periudhën 2026-2028. Gjatë takimit është trajtuar çështja e shtyrjes së afatit të dorëzimit të dokumentacionit tarifor, si dhe është paraqitur kërkesa për shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave, për shkak të rritjes së ndjeshme të shpenzimeve mujore të energjisë elektrike pas kalimit në tregun e lirë.
2.	Takim me projektin FLOWS-palët e involvuara të listuara më poshtë: • KRU Hidromorava • Komuna e Gjilanit • Investitori • Mbikqyrësi dhe • Operatori Ekonomik	13.08.2025	Është mbajtur takim lidhur me ecurinë e projektit FLOWS, ku janë diskutuar sfidat që po paraqiten gjatë realizimit të punimeve. Një nga çështjet kryesore të ngritura, me iniciativë të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, ka qenë asfaltimi i rrugëve pas përfundimit të punimeve. Gjatë takimit është shqyrtuar progresi i deritanishëm, aktivitetet që planifikohet të zhvillohen në vazhdimësi, si dhe janë adresuar vonesat në projekt të shkaktuara nga nevoja për ridizajnimin e tij.
3.	Takim me Operatorin Ekonomik, për projektin e Cërnicës	13.08.2025	Është zhvilluar takim me operatorin ekonomik, mbikëqyrësin dhe menaxherin e projektit, me qëllim të shqyrtimit të ndryshimeve të rekomanduara në projekt. Gjatë takimit janë diskutuar mundësitë për zvogëlimin e kostos së projektit dhe arsyet që e bëjnë të pamundur realizimin e tij në formën fillestare të parapare në dokumentacionin projektues.
4.	Takim me Zyrtarët e Drejtorisë së Urbanizmit	25.09.2025	Është zhvilluar diskutim lidhur me informacionet dhe të dhënat që duhet të përgatiten nga zyrtarët e KRU "Hidromorava" Sh.A., të cilat janë të nevojshme për proceset e planifikimit të ardhshëm nga ana e Komunës.
5.	ARRU	26.09.2025	Në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesor Financiar dhe menaxherin e Divizionit të Planifikimit, është mbajtur

			takim në zyrat e ARRU-së, ku janë diskutuar projektet, shpenzimet dhe planifikimet për periudhën trevjeçare 2026–2028, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në procesin tarifor. Gjatë takimit janë marrë rekomandimet e nevojshme lidhur me ndryshimet që është dashur të bëhen në dokumentacionin përkatës.
6.	Takim me kompaninë projektuese të Projektit të Cernicës	30.09.2025	Në bashkëpunim me Menaxherin dhe Mbikëqyrësin e projektit, është zhvilluar takim me kompaninë projektuese me qëllim të marrjes së aprovimit për ndryshimet e propozuara në projekt.

8.2 Divizioni për Prodhimin e Ujit dhe Stacionet e Pompimit

8.2.1 Furnizimi me ujë dhe defektet e paraqitura

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025 është vërejtur një rënie e ndjeshme e nivelit të ujit në akumulacionin e Përlepnices, i cili më datë 15.10.2025 ka arritur nivelin prej 21.36 m. Edhe burimi "Baja" ka shënuar rënie të debitit, çka ka detyruar ndërprerje të përkohshme të furnizimit gjatë ditës për të mundësuar mbushjen e rezervuarëve.

Burimet tjera ujore në rajon, si "Guri i Hoxhës" dhe pusët në Velekincë, kanë qenë në gjendje më të qëndrueshme, megjithëse është vërejtur një rënie e lehtë e kapacitetit. Në disa sisteme rurale janë raportuar ndërprerje të herëpashershme të furnizimit, si pasojë e uljes së niveleve të ujit.

Funksionimi i stacioneve të pompimit është zhvilluar përgjithësisht pa probleme të mëdha; defektet e paraqitura në rrjetin e ujësjetës janë adresuar në kohë falë reagimit efikas të ekipeve teknike. Përpjekjet gjatë kësaj periudhe janë përqendruar në ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet prodhimit dhe konsumit, me qëllim shmangien e mbiprodhimit dhe mbrojtjen e infrastrukturës. Gjatë kësaj periudhe, sasia totale e ujit të prodhuar ka qenë 2,546,065 m³, ndërsa sasia e faturuar ka arritur në 1,257,364 m³, që përkon me një UPF prej 50.2%.

Pavarësisht disa problemeve teknike të hasura në stacionet e pompimit në Kopernicë, Topanicë, Bilinicë, Zhegër, Malësi të Kamenicës dhe Ropotovë, defektet janë eliminuar në kohë të shkurtër, pa ndikuar ndjeshëm në vazhdimësinë e furnizimit me ujë.

Defektet e evituara gjatë kësaj periudhe janë:

- 09.07.2025 - Lagjja Malësia: Është ndërprerë funksionimi i elektropompës për shkak të dëmtimit të motorit 2.2 kW; pajisja është zëvendësuar dhe furnizimi me ujë është rikthyer.
- 09.07.2025 - Malishevë: Është rregulluar regjimi i pompimit dhe është sanur kablloja e dëmtuar nga kontraktori "Alfa-I" (projekti FLOWS); sistemi është funksionalizuar.
- 18.07.2025 - Koretin: Është ndërhyrë në zëvendësimin e kontaktorit dhe rele të nivelit; furnizimi është rikthyer.
- 21.07.2025 - Kamenicë, Stacioni Nr.2: Është konstatuar dëmtimi i dy elektromotorëve 2.2 kW; riparimi është realizuar nga kontraktori "EJONA".
- 22.07.2025 - Rezervuari "Kodra e Dëshmorëve": Është evidentuar dëmtimi i routerit të komunikimit.

- 23.07.2025 - Qendra e paraburgimit: Është eliminuar ajri në elektropompën centrifugale vertikale dhe sistemi është kthyer në punë.
- 25.07.2025 - Stacioni Nr.2: Është zëvendësuar siguresa tre-polare e dëmtuar, duke funksionalizuar pompën.
- 26.07.2025 - Grizime: Është ndërruar siguresa tre-polare 63 A.
- 31.07.2025 - Pozhoran dhe Sodovinë: Pas punimeve të KEDS-it, është rregulluar renditja e fazave elektrike dhe sistemi është rivendosur në funksion.
- 01.08.2025 - Kamenicë, Stacioni Nr.2: Është zëvendësuar relëja kohore e dëmtuar dhe është rikthyer furnizimi.
- 18.08.2025 - Kmetoc: Është rregulluar regjimi i pompimit.
- 19.08.2025 - Kamenicë: Është zëvendësuar elektromotori 5.5 kW në Stacionin Nr.1 dhe është sanur kablloja e dëmtuar në Stacionin Nr.2.
- 22.08.2025 - Fabrika e ujit: Është riparuar pompa dozuese e kaliumit dhe është kthyer në funksion.
- 25.08.2025 - Kamenicë, Stacioni Nr.2: Është zëvendësuar kontaktori i dëmtuar dhe është izoluar kablloja e pompës dozuese.
- 26.08.2025 - Muqivërc: Është zëvendësuar pompa zhytëse 7.5 kW dhe sistemi është kthyer në punë.
- 05.09.2025 & 29.09.2025 - Fabrika e Velekincës: Është realizuar pastrimi manual i filtrit nr.2 për shkak të defektit të aktuatorit të ujit të papastër. Tenderi për zëvendësimin e pajisjes është shpallur dhe pritët përzgjedhja e operatorit.
- 08.09.2025 - S.P. Baja: Është eliminuar defekti në pompën nr.3 (problemi në kontaktet e përçuesit të relës).
- 12.09.2025 - Bilinicë: Është ndaluar funksionimi i elektropompës për shkak të dëmtimit të elektromotorit dhe kontaktorit; pas zëvendësimit, sistemi është funksionalizuar.
- 15.09.2025 - Fabrika e Përlepnices: Është servisuar pompa dozuese e kaliumit dhe i është shtuar vaji teknik.
- 15.09.2025 - Vërbicë e Kmetovcit: Është pastruar ventili elektrik i stacionit të pompave.
- 22.09.2025 - Paraburgimi & Baja: Është ristartuar komunikimi ndërmjet rezervuarit dhe S.P. Baja; gjithashtu është filluar instalimi i rrymës në depon e re, aktiviteti i përfunduar më 30.09.2025.
- 23.09.2025 - Kamenicë & Grizime: Është instaluar nga një elektropompë e re me fuqi 3 kW në secilin lokacion.

Aktivitetet tjera mbështetëse:

- Riparimi i gjeneratorit në Impiantin e Përlepnices: Tenderi është anuluar dy herë për shkak të mospërbushjes së kritereve nga operatorët ekonomikë; ankesa aktualisht gjendet në OSHP.
- Mirëmbajtja e ambientit të rezervuarëve: Është vazhduar me kositjen e barit në hapësirat e rezervuarëve ruralë, në impiantin e Përlepnices dhe në disa stacione pompimi.
- Tenderimi për aktuatorë në fabrikën e Velekincës: Është përgatitur paramasa për furnizim me aktuatorë të rinj, për shkak se njëri filter aktualisht operon vetëm mekanikisht.

8.2.2. Implementimi i projektit FLOWS

Punimet në kuadër të projektit FLOWS janë duke u zhvilluar sipas planit dhe deri më tani nuk janë evidentuar probleme të theksuara që do të mund të ndikojnë në ndërprerjen e tyre.

Gjatë kësaj periudhe, kontraktori ka përfunduar punimet për instalimin e sistemit të klorimit me gaz në dy fabrika, megjithatë, për shkak të ndryshimeve të domosdoshme të projektit në stacionin e pompave "Baja", punimet që lidhen me sistemin e klorimit dhe aktivitetet tjera përkatëse janë pezulluar deri në marrjen e përgjigjes nga Banka Botërore.

8.2.3. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit

Sasia e ujit të prodhuar dhe të faturuar, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025, sipas analizës së bërë nga koordinatori për UPF-në, është paraqitur në tabelën nr.36.

Tabela 36. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM3/2025

Burimi	Prodhimi (m ³)	Faturimi për (m ³)	UPF (%)
FPU Përlepnice dhe Guri i Hoxhës	1,141,999	896,319	45.83
FPU Velekincë	358,483		
Baja*10	154,283		
Pasjan (komulative)	11,978	1,887	84.25
Malishevë e Ulët	14,925	16,322	-9.36
Llovcë	990	1,050	-6.06
Dobërçan*10	15,235	10,131	33.5
Zhegër*10	71,610	33,406	53.35
Bilinicë	1,528	1,095	28.34
FPU Letnicë - Viti	288,260	73,448	74.52
Trestenik	71,750	22,654	68.43
Pozharani	80,420	46,997	41.56
Ujës-jellësi Letnicë	4,010	1,182	70.5
Stacioni i pompimit 1, Kamenicë	27,420	88,487	53.41
Stacioni i pompimit 2, Kamenicë	22,767		
Stacioni i pompimit 3, Kamenicë	10,275		
Stacioni i pompimit 4, Kamenicë	54,071		
Stacioni i pompimit 5, Kamenicë	17,760		
Stacioni i pompimit 6, Kamenicë	57,621		
Topanicë	25,159	18,924	24.78
Kopernicë & Kolloleç	18,220	7,028	61.43
Koretin	27,274	12,131	55.52
Shipashnicë	26,620	7,230	72.84
Karaçevë	9,258	5,103	44.88
Ranillug	7,041	7,834	-11.26
Ropotovë	5,608	3,193	43.06
Boston, Qulkoc, Makresh	15,374	4,015	73.88
Koretisht& Pasjak			
Prodhimi total m³/TM3 2025	2,539,939	1,258,436	50.45

Sipas tabelës së përpiluar, rezulton se gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 është prodhuar ujë i pijshëm në sasi prej: 2,539,939m³, është faturuar 1,258,436m³ dhe UPF rezulton në 50.45%.

8.3 Mirëmbajtja e Rrjetit të Ujësllësit

Në përgjithësi në zonat e shërbimit gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, kemi pasur (500) intervenime të natyrave të ndryshme si rrjedhje/plasaritje të gypave në rrjet, dëmtim i valvulave etj.

Në Njësine Operative në Gjilan kanë qenë (283) intervenime, në Njësine Operative në Kamenicë (179) intervenime, në Njësine Operative në Viti (26) intervenime, në Komunën e Ranillugut (5) intervenime dhe në Komunën e Novobërdës (7) intervenime, ndërsa në Komunën e Parteshit nuk ka pasur intervenime në rrjetin e ujësllësit.

Tabela 37. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM3/2025

Zona e shërbimit	Numri i defekteve	Lagjet/rrugët/vendbanimet	Natyra e defekteve
Gjilan	283	Korrik: Fshatrat: Shillovë, Nasalë, Përlepnice, Malishevë, Zhegër, Livoç i Ulët; Rrugët: Velekincë Rr. "Isa Kastrati", Rr. "Naser Azemi" Rr. "Mulla Idrizi", Rr. "Vëllezërit Maliqi", Rr. "Ismet Jashari", Rr. "Arben Ramadani", Rr. Rr. "Ahmet Malisheva", Rr. "Hysen Tërpeza", Rr. "Xhemajl Mustafa", Rr. "Muharrem Kurteshi", Rr. "Beqir Musliu", Rr. "Marie Shllaku", Rr. "Abdullah Presheva", Rr. "Edit Durhan", Rr. "Muhaxherët", Rr. "Bajram Llovca", Rr. "Shadërvani", etj. Gusht: Fshatrat: Malishevë, Zhegër, Shillovë, Nasalë, Përlepnice, Zhegër, Livoç i Ulët, Velekincë; Rrugët: Rr. "Vudro Vilson", Rr. "Mulla Idrizi" Rr. "Valbona", Rr. "Isa Boletini", Rr. "Idriz Seferi", Rr. "Xhemajl Mustafa", Rr. "Hysen Tërpeza", Rr. "15 Qershori", Rr. "Vëllezërit Llozana", Rr. "Murat Kryeziu" Rr. "Esat Berisha", Rr. "Shkupi", Rr. "Abdullah Presheva", Rr. "Fehmi Agani", Rr. "Murat Kryeziu", Rr. "Enver Hadri", Rr. "Evlija Çelebia" etj. Shtator: Fshatrat: Zhegër, Kosaqë, Malishevë, Llovçë, Përlepnice, Livoç i Ulët, Velekincë; Rrugët: Rr. "Nafije Gashi", Rr. "Nëna Terezë", Rr. "Perandori Justinian", Rr. "Marie Shllaku", Rr. "Xhevat Ajvazi", Rr. "Beqir Musliu", Rr. "Xheladin Kurbaliu", Rr. "Lufta e Gjilanit", Rr. "Igballe Prishtina", Rr. "Muharrem Ibrahim", Rr. "Fadil Jakupi", Rr. "Mustafë Koka", Rr. "Kuvendi i Gjilanit", Rr. "Taulantina", Rr. "Hysen Tërpeza", Rr. "Vëllezërit Frashëri", Rr. "Bregu i Djegun", etj.	Rrjedhje në rrugë (122) dhe rrjedhje në puseta (161).

Novobërdë	7	Korrik: Fshati: Tullar. Gusht: Fshati Tomancë dhe Boston. Shtator: Fshatrat: Tomancë, Boston, Qulkovc, Panqellë.	Rrjedhje në rrugë (6) dhe rrjedhje në puseta (1).
Ranillug	5	Korrik: Fshatrat: Ropotovë, Glllogovc. Gusht, Shtator: Fshati Ropotovë.	Rrjedhje në rrugë (1), rrjedhje në puseta (4).
Kamenicë	179	Korrik: Fshatrat: Karaçevë e Poshtme, Kopernicë, Kolloleq, Topanicë, Shipashnicë e Epërme dhe Koretin. Rrugët: "Beteja e Kikës", "Majstorska", "Skenderbeu", "Doruntina", "Sylë Zarbinca", "Ilir Konushevc", "Nexhmedin Kuqi", "Sefë Kosharja", "Azem Bejtë Galica", "Tahir Sinani", "Gjergjecal", "Tahir Sinani", "Adem Jashari", "Ali Hadri", "Ismajl Ismajli", "Dardanët", "Ajet Kosovica", "Besnik Maroca", "Çerçiz Topulli". Gusht: Fshatrat: Karaçevë e Poshtme, Kopernicë dhe Topanicë, Shipashnicë e Epërme, Koretin. Rrugët: "Çerçiz Topulli", "Mbreti Gent", "Zhuji Selmani", "Nexhmedin Kuqi", "Dedë Xhon Luli", "Lot Vaku", "Adem Jashari", "Sali Çeku", "Gollaku", "Tahir Sinani", "Musti Imeri", "Sefë Kosharja", "Vuk Karagjiq". Shtator: Fshatrat: Shipashnicë e Epërme, Karaçevë e Poshtme, Toapnicë, Koretin, Kopernicë. Rrugët: "Skenderbeu", "Florim Imeri", "Muli Imeri", "Hafiz Ali Korça", "Komandant Gaca", "Tahir Sinani", "Nexhmedin Kuqi", "Beteja e Kikës", "Ilir Konushevc", "Besnik Maroca", "Mulloset", "Sefë Kosharja", "Sali Çeku" dhe "Vëllezërit Bytyqi".	Rrjedhje në rrugë (61), rrjedhje në pusetë të ujëmatësve (102), shkqyje nga rrjeti (6), verifikime (3) dhe zhvendosje e ujëmatësit (7).
Viti	26	Korrik: Fshatrat: Sadovinë e Jerlive dhe Sadovinë e Çerkezve. Rrugët: "Agim Ramadani", "Shota dhe Azem Galica". Gusht: Fshatrat: Sadovinë e Çerkezëve, Sadovinë e Jerlive, Pozhoran, Tërstenik dhe Sadovinë e Muhaxherëve. Shtator: Sadovinë e Çerkezëve, Sadovinë e Jerlive, Pozhoran, Tërstenik, Ramnishtë dhe Radivojc.	Rrjedhje në rrugë (22), defekte në puseta (4).
Totali:	500		

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, ndërprerje të ujit për shkak të defekteve në rrjetin e ujësjellësit ka pasur në lagjet/rrugët:

Muaji korrik 2025:

- Në Rrugën "Muharrem Kurteshi" është ndalur uji rreth tri orë për shkak të defektit në gypin kryesor,
- Në Rrugën "Bajram Llovca" është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në fshatin Kopërnice, është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4 PE;
- Në fshatin Koretin, është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në gypin DN 63 mm PE;
- Në Rr. "Tahir Sinani", është ndalur uji rreth një orë për shkak të defektit në gypin DN 5/4 PE;
- Në fshatin Koretin, është ndalur uji rreth një dy për shkak të defektit në gypin DN 6/4 PE;
- Rrjedhjet e tjera kanë qenë në diametër $\frac{3}{4}$ ose 1", të cilat janë evituar në presion ose për një kohë të vogël është ndalur uji.

Muaji gusht 2025:

- Në fshatin Përlepnice është ndalur uji rreth dymbëdhjet orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në fshatin Shillovë është ndalur uji rreth tetë orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rrugën "Hysen Tërpeza" është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesor ;
- Në fshatin Karaçevë e Poshtme është ndalur uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin DN 90 PE;
- Në fshatin Topanice, është ndalur uji rreth dy orë për shkak të defektit në puseten kryesore degëzuese në rrugë;
- Rrjedhjet e tjera në Nj.O. Kamenice kanë qenë në diametër $\frac{3}{4}$ ose 1", të cilat janë evituar në presion ose për një kohë të shkurtër është ndalur uji.

Muaji shtator 2025:

- Në fshatin "Livoç i Ulët" është ndalur uji rreth tre orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në lagjen "Dardania 2" është ndalur uji rreth katër orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në Rrugën "Vëllezërit Frashëri" është ndalur uji rreth tetë orë për shkak të defektit në gypin kryesor;
- Në fshatin "Përlepnice" është ndalur uji rreth dymbëdhjetë orë për shkak të defektit në gypin kryesor.

Shënim: Për shkak të natyrës së punës të evitimit të rrjedhjeve, shumica e defekteve janë evituar në shtypje pa e ndalë ujin fare, këto raste janë kur defektet janë në profil të gypit të vogël ose kur nuk është i dëmtuar gypi shumë.

8.3.1. DMA - zonat

Në zonën e shërbimit për regjionin e Gjilanit i kemi (6) gjashtë zona DMA:

1. Lagjen Dardania 1 dhe 2;
2. Livoç i Ulët;
3. Kufcë e Epërme;
4. Kmetovc dhe Verbiçë e Kmetovcit;
5. Shillovë e Muhaxherëve dhe
6. Zona më e madhe është ajo ku përfshihen Lagjet e Zabelit, Arbërisë, Velekinca dhe Bregu i Djegun.

Tabela 38. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë periudhës së TM3/2025 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit

	Burimi	Prodhimi (m ³)	Faturimi për (m ³)	UPF (%)
1.	Rr. "Lidhja e Prizrenit" *10	79,000	160,156	45.45
2.	Lagjja "Bregu i Djegun" (te ish kombinati i duhanit)	16,519		
3.	Rr. "Hysen Tërpeza"	16,851		
4.	Lipovicët	33,930		
5.	Mbrapa shkollës në Velekincë DN 63	7,880		
6.	Velekincë DN 90	24,591		
7.	Rr. "Mulla Idrizi"	101,680		
8.	Rr. "Esat Berisha" *10	13,150		
9.	Shillova 1	1,036	3,136	-6.52
10.	Shillova 2	2,944		
11.	Kmetovc	19,209	18,061	5.97
12.	Kufcë e Epërme	9,719	5,973	38.54
13.	Livoç i Ulët	41,040	18,670	54.50
14.	Lagjja "Dardania 1" *10	56,600	66,847	33.47
15.	Lagjja "Dardania 2" *10	43,880		
	Prodhimi total m³/TM3	468,029	272,843	41.7

Në zonën e shërbimit për regjionin e Kamenicës kemi një zonë DMA:

Berivojcë - Lagjja Iliria

Në zonën e shërbimit për regjionin e Vitisë i kemi dy zona DMA:

1. **Pozhorani**
2. **DMA Zonë mbrenda qytetit të Vitisë.**
- 3.

8.4. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, në rrjetin e kanalizimit kanë qenë gjithsej: 437 intervenime duke përfshirë Njësitë Operative në Gjilan, Kamenicë dhe Viti.

Tabela 39. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM3/2025

Njësia	Numri i intervenimeve	Përshkrimi
Gjilan	1226	Pastrim i pusetave
	349	Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave
Viti	36	Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave
Novobërdë	/	Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave
Partesh	/	Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave
Kamenicë	52	Debllokime kanalizimi dhe pastrim i pusetave
Total:	437	

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu, në Nj.O. në Gjilan, kemi pasur (10) intervenime me autocisternë si dhe (13) vendosje të kapakëve në puseta të kanalizimeve.

Tabela 40. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM3/2025 në Gjilan

Muaji	Gjatësia e rrjetit të kanalizimit (km)
Korrik	10.41 km
Gusht	11.88 km
Shtator	14.49 km
TOTALI	36.78 km

8.5 Divizioni për planifikim dhe menaxhim të projekteve

8.5.1. Aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, Divizioni për Planifikimin dhe Menaxhimin e Projekteve ka realizuar aktivitetet e paraqitura në tabelën më poshtë:

Tabela 41. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë periudhës së TM3/2025

Aktivitet	Numri i aktiviteteve
1. Pëlqime në parim për banime kolektive dhe afarizëm	12
2. Pëlqim në parim për banim individual	37

3.	Pëlqim në parim për institucione	2
4.	Evidentimi i intervenimeve në GIS	130
5.	Insertimin e kërkesave të reja për kycje në rrjetin e ujësjellësit	78
6.	Vlerësim të ofertave në Prokurim	11
7.	Menaxhim dhe mbikëqyerje të kontratave	5
8.	Inçizimi i rrjetit të kanalizimit fekal (puseta)	467

Përveç këtyre aktiviteteve të paraqitura në tabelë, zyrtarët nga divizioni i Planifikimit janë të angazhuar edhe në tri projekte të rëndësishme në zhvillimin e kompanisë siç janë:

1. Projekti FLOWS (Nxitja dhe shfrytëzimi i mundësive për sigurinë e ujit)

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025, punimet në terren nga Operatorët Ekonomikë kanë vazhduar me intensitet, ku janë realizuar ndërhyrje në disa segmente:

- Gjatë kësaj periudhe, në kuadër të projektit janë realizuar punimet në rrugën Medlin Ollbrajt (Linja 2, Sec B, 1244 m) ku është bërë shtrirja e gypit, ndërkohë që vazhduan punimet në rezervuarin e Përlepnicsë, u finalizua rrethoja tek stacionet e pompimit Baja dhe Burgu, dhe u fillua shtrimi i gypit FI 350 PE në rrugën Hamdi Kurteshi.


2. Projekti ITUN (Impianti i trajtimit të ujrave të zeza)

Gjatë periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2025 janë zhvilluar këto aktivitete:

- Gjatë kësaj periudhe janë përpiluar draft-kontratat për mbikëqyerje dhe për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit (kolektorëve), është pranuar raporti për fazën e dytë të ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza dhe është hartuar dhe dorëzuar dokumentacioni për kushtet ndërtimore për kolektorët.
- Është përpiluar paramasa dhe parallogaria, si dhe është përgatitur dosja e tenderit për furnizimin me ujëmatës.
- Është përpiluar paramasa dhe parallogaria, si dhe është përgatitur dosja e tenderit për projektet e aprovuara nga ME, përfshirë zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kycjet individuale në zonën urbane të Gjilanit – Lagjja Fidanishte II (Projekti i Fidanishtes), si dhe furnizimin me ujëmatës, bllokues dhe plomba për ujëmatës.



U.D. Kryesues i Bordit të Drejtorëve
KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan



z. Habil Zeqiri



**KRU
HIDROMORAVA**

 **KRU
HIDROMORAVA**

Na kontaktoni

info@kru-hidromorava.com

Adresa:

Rr. Vëllezrit Gërvalla, Nr. 71,
Gjilan, Republika e Kosovës



0800 61 000



<https://kru-hidromorava.com/>